



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1418/6 prot.

Datë 12.08.2024

V E N D I M
Nr. 1034/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.08.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-93267-01-17-2024, me objekt “*Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore*”, me fond limit 17,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, me NIPT (L61814009B) dhe adresë: Pasuria Nr.1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.

Operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, me NIPT (L28029301Q) dhe adresë: Afër ish Kanalit të Acidit, Fushëkuqe, Kurbin, Lezhë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, me adresë: Lagja “Partizani”, Vlorë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimes, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.01.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-93267-01-17-2024, me objekt “*Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore*”, me fond limit 17,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 03.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “V.A.L.E Recycling” SHPK	13,125,055	kualifikuar
2. “Medi - Tel” SHPK	15,519,877.8	skualifikuar
3. “Eco Riciklim” SHPK	17,071,865.58	kualifikuar

II.4. Në datën 28.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “V.A.L.E Recycling” SHPK	13,125,055	skualifikuar
2. “Medi - Tel” SHPK	15,519,877.8	skualifikuar
3. “Eco Riciklim” SHPK	17,071,865.58	skualifikuar

II.5. Në datën 29.05.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Anulimit të procedurës së prokurimit.

II.6. Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

NUK PERMBUSHNI SPECIFIKIMET E PERCAKTUARA NE SHTOJCEN 5 PASI NE DEKLARATEN PER PERDORIMIN E KONTENITOREVE NJEPERDORIMSH QE DO TE PERDOREN PER AMBALLAZHIMIN E MBETJEVE SPITALORE I JENI DREJTUAR NJE AUTORITETI TJETER KONTRAKTOR SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK KOCO GLIOZHENI TIRANE

II.6.1. Në datën 03.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4151, dhe nr. Protokollit 1418/2024, datë 04.06.2024, të operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur

nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon: “A. Ne lidhje me menyren e zhvillimit të procedurave:

Ak ka publikuar në spe me datë 16.05.2024 rezultatet e shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave dhe në vijim me datë 28.05.2024 ka publikuar një vendim të ndryshëm për shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave.

Keto veprime të ak, janë në kundërshtim me nenin 97 (1) të lpp, ku përcaktohet se: menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vleresimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatoreve ekonomike i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

Edhe nëse kjo reflekton ndonjë ndryshim në rezultatit të vleresimit, kjo mund të ndodhë vetëm për ato çështje që pasqyrohen në dokumentacionin fizik që paraqitet nga ofertuesi i renditur i pari, në zbatim të nenit 26 të vkm nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe jo për ofertat e ofertuesve të tjerë mbi të njëjtat dokumenta të dorëzuara në spe që janë vlerësuar një herë.

B. Ne lidhje me skualifikimin e ofertes sone:

Oferta jone është refuzuar pasi sipas kvo: inuk përmbushni specifikimet e përcaktuara në shtojcën 5, pasi në deklaratën për përdorimin e kontenitoreve njëpërdorimesh që do të përdoren për ambullazhimin e mbetjeve spitalore i jeni drejtuar një autoriteti tjetër kontraktor, spitalit universitar obstetrik gjinekologjik koco gloxheni, tiranë

Ky qëndrim i kvo është i pabazuar në ligj dhe në dst pasi:

Kriteri i përcaktuar në dst, në lidhje me kontenitorët është kriteri 2.3.7. Që përcakton se: 2.3.7. Operatori duhet të furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të specifikimeve teknike dhe termave të referencës. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë për secilin lloj kontenitori:

? Katalog ose skedë teknike

Pra, duket qartë se për përmbushjen e këtij kriteri, ak ka kërkuar që të paraqitet për secilin lloj kontenitori i katalog ose skedë teknike

Në përmbushje të kësaj kërkesë nga ana jone janë paraqitur të gjithë skedat teknike për secilin lloj kontenitori dhe konkretisht është depozituar në spe dokumentacioni si vijon (aneks 4, 5, 6, 7, 8):

- 30 skedë teknike kontenitor 3l-12l (me_kapak_te_kuq&bardhe)
- 31 skedë teknike kontenitor 40 l -60l
- 32 skedë teknike 40 l kontenitor i kuq
- 33 skedë teknike kontenitor kartoni 60l
- 34 foto_kontenitore

Keto dokumenta, që janë të vetmet të kërkuara nga ak për verifikimin e përmbushjes së këtij kriteri vertetojnë dhe përmbushin plotësisht kërkesat e përcaktuara nga ak në dst. Deklarata të ciles i referohet kvo si shkak për refuzimin e ofertes, është një dokument që në fakt nuk është kërkuar në dst, por thjesht një dokument shtesë i dorëzuar në menyre fakultative nga ana jone. Në këtë kuptim, kvo duhet të kishte zbatuar nenin 92 (3) të KPP dhe të kishte ruajtur vleresimin e parë të ofertes sone si e vlefshme, pasi ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit dhe jo të bente

rivleresim pa shkak, per me teper duke e skualifikuar oferten tone per shkaqe dhe/ose kerkesa qe nuk jane percaktuar ne dst.

Edhe sikur nje deklarate e tille te ishte kerkuar, serish, kvo nuk ka gjetur asnje specifikim apo kerkee qe nuk plotesohen, por thjesht i referohet nje lapsusi ne lidhje me ak te cilit i drejtohet deklarata, qe sidoqofte ne situaten hipotetike kur nje deklarate e tille do ishte kerkuar, do duhej te ishte konsideruar thjesht nje devijim minor.

Per me teper, gjithsesi plotesimi ne menyre te detajuar i specifikimeve teknike dhe termave te references nuk mund te verifikohet nepermjet deklaratave te oe, por nepermjet ndjekies dhe monitorimit te zbatimit te kontrates, pasi ajo eshte lidhur dhe ka filluar zbatimi i saj.

C. Ne lidhje me shtimin e shkaqeve te skualifikimit te ofertes se oe V.a.l.e Recycling meqenese, nga publikimi ne spe, nuk merret informacion i plote ne lidhje me shkaqet e skualifikimit te oe V.a.l.e Recycling, me ane te kesaj ankese kerkojme qe pervec shkaqeve qe jane renditur nga kvo, te shtohen edhe shkaqet si vijon:

1. Oe va.l.e recycling sh.p.k., nuk ploteson kriterin 2.1.3 qe percakton se: òoperatori ekonomik duhet te paraqese akt miratimin higjeno ñsanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit te mbetjeve spitalore, te leshuar nga ishsh (inspektoriat shendetesor shteteror).

Nga informacioni qe kemi per oe V.a.l.e Recycling, per shkak te konkurimit ne shume procedura prokurimi prej shume vitesh, ku kemi marre edhe informacion nepermjet kerkesave tona per informacion, na rezulton se ky oe disponon nje akt miratimi higjeno sanitar te vitit 2017, qe eshte leshuar per instalime te trajtimit te mbetjeve spitalore, por qe specifikon se mbulon instalimet autoklave, mulli, magazine (aneks 9).

Pra, akt miratimi higjieno sanitar ne fjale, nuk mbulon edhe instalimin e inceneratorit, cka do te thote, se objekti per pjesen qe ushtron aktivitetin e incenrimit, nuk eshte i pajisur me akt miratimi higjieno sanitar.

Ne rrethanat e mesiperme, kriteri 2.1.3 duhet te konsiderohet i paplotesuar.

2. Oe V.A.L.E Recycling sh.p.k., nuk ploteson kriterin 2.3.6 qe percakton se: òoperatori ekonomik duhet te disponoje kontrate te lidhur me nje subjekt te lejuar nga akm per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti ne fjale duhet te jete i autorizuar ne lejen mjedisore perkatese per te pranuar produktin final qe del nga procesi i trajtimit me teknologjine pa djegie pjese e grupit te kodeve 19 03 te katalogut shqiptar te mbetjeve dhe produktin final qe del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenrimit) pjese e grupit te kodeve 19 03 te katalogut shqiptar te mbetjeve. Per permbushjen e ketij kriteri ofertuesit duhet te paraqesin: kontrate /akt mareveshje me subjektin e licensuar per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi te jete aktive ne momentin e dorezimit te ofertave

Nga monitorimi i tregut dhe i konkuresces, na rezulton se oe V.a.l.e Recycling, per permbushjen e ketij kriteri, disponon kontrate te lidhur me shoqerine eco ñ elb sh.a., e cila per pranimin e produktit final qe del nga proceset e trajtimit te mebtjeve spitalore me teknologjine pa djegie dhe ate me djegie, disponon lejen mjedisore me pn-5783-09-2017, me nr.identifikimi 2694/1 date 30.06.2022 (aneks 10 i bashkelidhet ankeses).

Ne kete leje mjedisore, percaktohet se nga pikepamja e shtrirjes territoriale, kjo leje, kufizohet ne ùmpjanti i trajtimit te mbetjeve urbane te qarkut te elbasanit dhe prodhimit te energjise.

Pra, sipas lejes ne fjale, ky landfill/impiant mund te pranoje per depozitim vetem mbetje te gjeneruara brenda qarkut te elbasanit. Pra, produktet perfundimtare te gjeneruara si mbetje/teprica per landfillim, ne nje qark tjeter, nuk jane te autorizuar nga leja ne fjale qe te depozitohen prane subjektit eco - elb.

Duke qene se qendra e ushtrimit te veprimtarise se oe V.a.l.e Recycling ndodhet ne qarkun e lezhes, edhe tepricat e gjeneruara nga proceset e trajtimit te mbetjeve nga ky oe, konsiderohen qe jane gjeneruar ne qarkun e lezhes, pra nuk mund te depozitohen prane eco-elb. Pavaresisht nga ekzistenca e ndonje kontrate mes ketyre subjekteve per kete qellim, kjo kontrate nuk ka asnje vlere, per sa kohe nuk eshte ne perputhje me kushtet e lejes mjedisore te subjektit prites. Pra, ne rrethanat e mesiperme, edhe kriteri 2.3.6, duhet te konsiderohet i papermbushur nga oe V.a.l.e Recycling.

3. Oe va.l.e recycling sh.p.k., nuk ploteson kriterin 2.3.5 qe percakton se:

Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi te njohur nga ligji, impiant/e, makinerite e meposhtme qe te mundesojte trajtimin e te gjitha kategorive te mbetjeve objekt i ketyre dst, sipas ligjit nr. 10463 date 22.09.2011 iper menaxhimin e integruar te mbetjevee, i ndryshuar, si dhe te vkm-se per miratimin e rregullores iper menaxhimin

E mbetjeve spitaloree, (rregullorja) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem, si me poshte:

A. Impiant per trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me te njejten metode ose ambjent magazinimi te

Percaktuar ekskluzivisht per mbetjet spitalore te prodhuara nga srv, jo me pak se 100 m2 sipas kushteve te rregullores per mbetjet spitalore.

B. Impiant per asgjесimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me te njejten metode ose magazinin e siperpermendur!

C. Makineri per larjen e konteniereve cope 1 dhe makineri back up ose zevendesues te tille (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem);

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te disponoje dokumentat e meposhtme provuese:

A. Dokumentacionin per vertetimin e pronesise, huaperdorjes ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

B. Te jene te pasqyruar ne akt miratimet e leshuara nga ministria e turizmit dhe mjedisit te paraqitura ne permbushje te kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 me siper;

C. Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjeter teknik i secilit impiant dhe makinerise;

D. Deklarate konformiteti ce i secilit impiant dhe makinerise.

E. Vetedeklarim mbi pronesine ose cdo lloj posedimi te njohur ligjerisht mbi ambjentin e magazines se mbetjeve e cila duhet te jete e shoqeruar me planimetri te leshuar nga organet kompetente (ne rastin kur o.e disponon magazine per mbetje si ekuivalent te impiantit te back up)

F. Vetedeklarim mbi kontratat qe operatori ekonomik ka nenshkruar me kete object prokurimi me qellim verifikimin e disponueshmerise se hapësirave te magazinimit te mbetjeve spitalore nga ana e kvo-se (ne rastin kur o.e disponon magazine per mbetje si ekuivalent te impiantit te back up).

Nga informacioni qe kemi per oe V.a.l.e Recycling, per shkak te konkurimit ne shume procedura prokurimi prej shume vitesh, kinformacionin qe kemi marre nga ak te ndryshme pas kerkesave tona per infomacion, si dhe raportimet mediatike, na rezulton se ky oe nuk e ploteson kriterin 2.3.5 per arsyet e meposhtme:

(i) ky oe, per inceneratorin efs 50 qe deklaroi, nuk ka nje katalog, skede teknike, apo dokument teknik te vlefshem qe te jete origjinar nga prodhuesi, por paraqet nje dokument pas asnje ekstremitet apo te dhena identifikuese, ku jane te pasqyruara ne menyre narrative dhe skematike te dhena per inceneratorin. Duhet sqaruar se qe nje dokument teknik te jete i vlefshem, ai duhet te jete ne nje forme te caktuar, ku dallohen qarte, te dhenat e prodhuesit, logo dhe shenja te ngjashme dalluese, adresat etj., cka edhe garanton se ky dokumentacion teknik eshte gjeneruar nga vete prodhuesi. Perndryshe, kushdo mund te prodhoje nje dokument me te dhena teknike, por nuk jep asnje garanci se keto i pergjigjen realitetit, pasi kete e garanton vetem autoresia e prodhuesit. Pra nuk plotesohet pika e kriterit te sipercituar, ku kerkohet katalog, skede teknike apo

Dokument tjeter teknin per inceneratoret.

(ii) nuk plotesohet kerkesa qe ky oe te disponoje 2 inceneratore (nje kryesor dhe nje back up) dhe keta te jene te perfshire ne lejen perkatese mjedisore. Ne fakt, duke iu referuar dokumentacionit qe ky oe ka dorezuar, rezulton se edhe pse ne lejen mjedisore tipi a, me pn-8024-01-2019, tregohen 2 inceneratore efs 50, vetem njeri mund te konsiderohet se eshte i perfshire ne lejen mjedisore ne fjale, ai i blere me faturen nr.2129 date 07.11.2017, ndersa deklarata doganore e dates 05.03.2024 per nje tjeter incenerator, nuk mund te konsiderohet se ploteson kerkesen qe oe te disponoje edhe incenerator back up dhe ky te jete i perfshire ne leje, pasi pasi nje incenerator i blere ne vitin 2024, nuk mund te konsiderohet se eshte i perfshire ne lejen qe eshte miratuar ne vitin 2019. Gjithashtu, as fatura e paraqitur e vitit 2017 dhe as deklarata doganore e vitit 2024, nuk tregojne qe behet fjale per incenerator efs 50 qe tregohen ne leje.

(iii) duke iu refruar informacionit nga qkb, rezulton se sipas lejes mjedisore tipi a, me pn-8024-01-2019, oe V.a.l.e Recycling deklaroi inceneratorin model efs n 50, prodhim kinez i kompanise shandong better environmental protection technology co., ltd. Kur ne kemi bere kerkime tregu per incenerator, kemi shqyrtuar edhe kete product dhe nje nga arsyet per te cilat nuk e kemi marre ka qene fakti se ky product nuk disponon deklarate konformiteti ce te prodhuesit.

Ne linkun e informacionit per prodhuesin ku renditen te gjitha kualifikimet e kesaj kompanie <https://ëëë.sdbetter.net/certificate.html>, prodhuesi nuk e deklaroi kete produkt me deklarate konformiteti ce. Tregtare te ndryshem te keitj produkti kur japin oferta qarkullojne edhe nje dokument te leshuar nga nje kompani ceertifikimi turke udem per certifikimin e atestimit medirektiven e makinerive 2006/42/ce, por ky dokument nuk eshte nje deklarate konformiteti pasi keto jane dy gjera te ndryshme, dhe sic edhe shprehet ne kete dokument imarka ce mund te perdoret nen pergjegjesine e prodhuesit vetem pas plotesimit prej tij te deklarates se konformitetit

Ce me direktivat perkatese.e gjithashtu, kjo certificate ateston vetem per machinery directive 2006/42/ec, nderkohe qe lista e direktivave dhe standarteve ce per te cilat duhet leshuar deklarata e konformitetit ce jane:

- bs en 746-2:1997

- *loe voltage directive 73/23/eec*
- *emc compatibility regulation 89/336/eec*
- *machinery directive 2006/42/ec (including amendment)*
- *(ec) no 1005/2009 on substances that deplete the ozone layer*

Ne kushtet e mesiperme, rezulton qarte se nuk plotesohet kerkesa qe cdo makineri te jete e pajisur me deklarate konformiteti ce, pasi inceneratori model efs n̄ 50 i deklaruar nga oe V.a.l.e Recycling, nuk eshte i pajisur me deklarate konformiteti ce.

(iv) ne kete kriter, gjithashtu kerkohet qe oe te kene impiant per trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me te njejten metode me te njejten metodee, duke paraqitur edhe dokumentat konkrete te kerkuara (doc te pronesise/posedimit, te jene te perfshire ne lejen mjedisore, katalog ose skede teknike etj, si dhe deklaraten e konformitetit ce).

Oe V.a.l.e Recycling, ka te listuara ne lejen mjedisore te tipit b me pn-9488-03-2015, me nr.1780, nje pajisje te tipit neester (te deklaruar ne lejen ne fjale me nr.1780/2 nga viti 2020) dhe nje pajisje te tipit econos (te perfshire ne lejen ne fjale me nr.1780/1 nga viti 2018). Por ne fakt, rezulton edhe nga raportimet mediatike te sipercituara, se ky oe nuk e disponon ne realitet pajisjen econos qe tregohet ne kete leje. Edhe sikur ky oe te kete importuar ne vitin 2024 nje pajisje econos, kjo nuk eshte pajisja qe tregohet ne lejen mjedisore me pn-9488-03-2015.

Pra, oe V.a.l.e Recycling ploteson kete kriter vetem per nje impiant per trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) n̄ me pajisjen neester, por nuk disponon impiant back up me te njejten metode, dhe as dokumentat qe kerkohen per kete (doc te pronesise/posedimit, te jete i perfshire ne lejen mjedisore, katalog ose skede teknike etj, si dhe deklaraten e konformitetit ce). Kjo sepse, ne realitet pajisja econos e deklaruar ne leje qe ne vitin 2018, nuk ka qene asnjehere e instaluar dhe as nuk disponon ky oe dokumentacion te rregullt qe kerkohet per ta provuar kete, sic jane:

- *dokument per te provuar pronesine/posedimin/dipsonimin qe te datoje ne vitin 2018 ose me heret;*
- *pajisja e disponuar te jete ajo qe eshte deklaruar ne lejen mjedisore ne vitin 2018*
- *deklarate konformiteti ce te vlefshme*

Duke u nisur nga sa parashtruar me siper, nese nuk eshte bere tashme nga kvo, kerkojme qe ne skualifikimin e oe V.a.l.e Recycling, te perfshihet edhe mospermbushje te kriterëve 2.1.3, 2.3.5 dhe 2.3.6.”

II.6.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1418/2 prot., datë 05.06.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, si dhe kriteret për të cilat, pretendon se nuk përmbushen nga operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6.3. Me anë të shkresës Nr.2306 prot., datë 05.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1418/3 prot., datë 06.06.2024, me objekt “*Informacion për procedurën me objekt: Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, për nevoja të SRV – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vjeçar (24 muaj). Fondi limit: 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) Lek pa Tvsh me Nr. Ref-93267-01-17-2024*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Eco – Riciklim” SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.7. Operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

- *Sipas te dhenave te qkb, licenca juaj e tipit a eshte e pezulluar. Perpos ketij fakti, kvo gjate kesaj periudhe ka verifikuar faktet si me poshte:*

- *Nuk permbush kriterin 2.3.5 te percaktuar ne dst, konkretisht katalog ose skede teknike te secilit impiant.*

Sipas dst o.e duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

A) dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

B) të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga ministria e turizmit dhe mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

C) katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerise;

D) deklaratë konformiteti ce i secilit impiant dhe makinerisë.

- *Gjithashtu, sterilizuesi neëstër në 15 nuk eshte i perfshire ne akt miratimet e leshuara nga ministria e turizmit dhe mjedisit me arsyetimin e operatorit ekonomik qe meqenese eshte impiant back up dhe nuk perdoret njekohesisht me sterilizuesin kryesor nuk eshte e nevojshme te perfshihet ne akt miratimin e lejes mjedisore perkatese.*

Kvo gjykon se ne baze te ligjit nr. 10081 date 23.02.2009 ”per licencat, autorizimet dhe lejet ne r.sh” neni 27 pavaresisht se prek apo jo kriteret e licencimit/lejimit, ky operator ekonomik duhet te pajiset me titullin e ndryshuar. Ne vijim te ketij arsyetimi, kvo gjykon se ky kriter nuk permbushet nga ana e o.e.

- *Persa i perket ndryshimit te emrit te nje prej pajijeve/impiantit ëfs-50, kvo ka shqyrtuar dokumentacionin: deklarate doganore date 05.03.2024 per incineratorin zmfs-50, deklaraten e kompanise prodhuese per ndryshimin e modelit nga ëfs-50 në zmfs-50 ne date 14.12.2023 si dhe të dhënat teknike të incineratorit zmfs-50 të cilat nuk korrespondojnë me të dhenat e inceneratoreve per te cilet o.e eshte pajisur me leje mjedisore te tipit a. Deklarata e konformitetit eshte leshuar per zmfs-50 dhe jo per impiantet qe o.e ka deklaruar ne shtojcen 9. Duke pasur parasysh faktin se ne dst eshte kerkuar : të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga ministria e turizmit dhe mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2, o.e ka deshtuar te provoje dhe dokumentoje se inceneratori zmfs-50 i cili eshte zhdoganuar me date 05.03.2024 nga kina është i përfshirë në lejen mjedisore te tipit a pasi kvo*

gjykon se ne baze te ligjit nr. 10081 date 23.02.2009 "per licencat, autorizimet dhe lejet ne r.sh" neni 27 pavaresisht se prek apo jo kriteret e licencimit/lejimit, ky operator ekonomik duhet te pajiset me titullin e ndryshuar.

- Ne baze te verifikimeve te kryera nga kvo ne qkb (urdher nr,141 date 04.04.2024 "per pezullimin e lejes mjedisore per subjektin vale recycling shpk), si dhe dokumentacionit qe o.e ka vendosur ne dispozicion nepermjet spe, (korrespondences midis komisionit te prokurimit publik dhe agjensise kombetare te mjedisit me nr.5268/1 prot date 17.05.2024) procesverbalit te vizites ne terren te kvo date 13.05.2024, si dhe korrespondences midis akm dhe o.e rezulton se: Gjate verifikimit ne terren te kvo date 13.05.2024, inceneratori efs-50 ishte ne pune duke kryer proceset e incenerimit, provuar kjo me ane te procesverbalit dhe foto, video te kvo-se ne vend. Nga administrimi i informacionit te paraqitur nga vet o.e, akm citon nder te tjera se ne procesverbalin e inspektimit date 25.04.2024, inceneroret efs -50 dhe zmfs -50 nuk ishin ne pune per efekt te zbatimit te urdherit 141 date 04.04.2024. Nga ana e o.e nuk na eshte vene ne dispozicion vendim gjykate per makinerite dhe pajisjet e cila ishte objekt kerkese nepermjet spe. Ne rast se o.e dispononte prova qe tregojne se licenca e tij nuk ishte e pezulluar me vendim gjykate duhej tja provonte kvo (referuar vendimit nr.80-2024-1075 date 17.04.2024 per pranimin e kerkeses per marrjen e mases se sigurimit, cituar ne shkresen 5080/1 prot, date 15.05.2024 te akm-se) theksojme se o.e ka barren e proves te provoi me dokumentacion se Permbush te gjitha kushtet e percaktuara ne dst.*

- Persa i perket specifikimeve te kontenitoreve te mbetje te diapazonit 3-12 litra te perkthyer dhe te noterizuara kvo gjykon se nuk e permbush skeden teknike per kontenoret c5 sb pasi perkthimi eshte kontraktor (shkruhet vellim 40lt dhe kapacitet 5 lt) dhe nga verifikimi i kryer ne ministrine e drejtesise nuk rezulton ne listen zyrtare e eksperteve(perkthyesve zyrtare te gjuhes italiane) pra ky specifikim nuk konsiderohet i permbushur nga ana e kvo-se.*

- Persa i perket magazinimit te mbetjeve per kvo nuk eshte bindese hapësira e vendosur ne dispozicion per magazinim ne rast defekti te impiantit kryesor, pasi nese ndodh ky defekt, do te kryhet magazinim i te gjitha mbetjeve te rrezikshme te te gjitha spitaleve/subjekteve me te cilet operatori ka kontrate aktive sipas shtojces se dst date 03.04.2024(shtojce e cila nuk eshte objekt ankimimi nga ana e operatoreve ekonomike)*

- Qe o.e ne keto kushte, kvo vendos unanimitisht skualifikimin e o.e.*

II.7.1. Në datën 04.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4155, dhe nr. Protokolli 1427/2024, datë 04.06.2024, të operatorit ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E Recycling" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendon:

Referuar arsyeve te skualifikimit paraqesim ankesen tone per sa me poshte vijon :

1. Referuar arsyes se pare te skualifikimit “SIPAS TE DHENAVE TE QKB, LICENCA JUAJ E TIPIT A ESHTE E PEZULLUAR. PERPOS KETIJ FAKTI, KVO GJATE KESAJ PERIUDHE KA VERIFIKUAR FAKTET SI ME POSHTEe, sqarojme :

Se pari, vlen te theksojme se ne asnje moment operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” nuk ka pasur dhe nuk ka asnje licence te pezulluar.

Se dyti, nisur nga arsyeja e skualifikimit, operatori ekonomik gjen me vend te marre per baze arsyetimin e KPP nr. Nr. 476/2024, ndaj te njejtit autoritet kontraktor, dhe konstatojne se momenti procedural i kErkimit tE dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor per permbushjen e kriterëve te pergjithshme dhe te veçanta te kualifikimit i (jo dokumentacioni I deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit) per operatorin ekonomik V.A.L.E Recyclinge SHPK, duhet te ishte data 16.05.2024, date ne te cilen referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton te jete permbyllur dhe procesi i vleresimit te ofertave nga ana komisionit te vleresimit te ofertave. Jo me kot ligjvenesi, ne varesi te llojit te procedures, ka parashikuar nje afat kohor (20 ose 15 dite) per procesin e vleresimit te ofertave duke dhene garanci per secilen prej paleve, KVO nga njera ane per kryerjen e nje vleresimi te thelluar e transparent dhe me mundesine edhe te kryerjes se verifikimeve prane paleve te treta ose sqarimeve nga operatoret ekonomike sa here lind nevoja, dhe operatoreve ekonomike pjesemarrës qe pas procesit te vleresimit te oferave dhe publikimit te njoftimit te fituesit paraprak apo anulimit te procedures te kene mundesi te mbrojne interesat e ligjshem duke ushtruar te drejten e ankimit ne autoritet kontraktor dhe ne KPP.

Po ashtu duke ndjekur arsyetimin e KPP ne vendimin Nr. 476/2024 konstatojme, se Brenda periudhes kohore qe ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur ne dipozicion momentin procedural per kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve te nevojshme per permbushjen e kriterëve te pergjithshme apo te veçanta te kualifikimit, derisa te konkludonte me mbylljen e procesit te vleresimit ne sistemin e prokurimit elektronik te dates 16.05.2024, çfare do te thote, se sipas vleresimit te KVO-se se autoriteti kontraktor, operatori ekonomik i ka permbushur kriteret per kualifikim. Ligjvenesi e ka parashikuar qarte ne nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 i per miratimin e regullave te prokurimit publike i ndryshuar, qe ne rastin e formularit permbledhes te vetedeklarimit bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit në Nenin 82, te LPP se, dhe ne keto rregulla. Per te vazhduar me piken 6 te VKM-se se sipercituar ku parashikohet se “6. Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, i be, ide, idhe, i ee, i he, i ie, i je te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin. NE kete kuader pas dorezimit te dokumentacionit ne forme shkresore nga operatori ekonomik i kualifikuar, i pari sipas autoritetit kontraktor (referuar kjo e kerkeses se ketij te fundit drejtuar ne SPE operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK me date 15.04.2024) KPP gjykoi, se vetem per dokumentet e deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit dhe qe kane sherbyer si prove paraprake, autoriteti kontraktor mund te shprehe vleresimin mbi perputhshmerine e tyre me ate qe operatori ekonomik ankimes ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE.

Ndersa per te gjithë dokumentet e tjera te ngarkuara ne sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur ne dispozicion momentin procedural te vleresimit te dokumenteve ne SPE deri me date 16.05.2024, kur ka perfunduar procesi i vleresimit ne SPE dhe njoftimi i operatoreve ekonomike pjesemarres mbi vleresimin per tûu shprehur ne lidhje me perputhshmerine e tyre me kriteret per kualifikim te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e percakton ne menyre te qarte qe nje oferte konsiderohet e vlefshme vetem nese ajo pembush te gjitha kerkesat per kualifikim, fakt te cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vleresimin e dates 16.05.2024, ku operatori ekonomik V.A.L.E. Recyclinge rezulton i kualifikuar. KPP ka gjykuar, se ligjvenesi ka percaktuar nje procedure te caktuar per tûu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore ne procesin e vleresimit te ofertave dhe vetem ne rastet e deklarimeve te paraqitura ne formularin permbledhes te vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE dhe qe sherbejne si prove paraprake vleresimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorezuar ne rruge shkesore mund te verifikoje perputhshmerine e deklarimeve te paraqitura ne formularin permbledhes te vetedeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar ne rruge shkresore.

Ndersa ne rastin konkret duke vazhduar arshzetimin e ndjekur nga KPP ne vendimin 476/2024, operatori ekonomik veren, se duhet te ishte data 16.05.2024 kur rezulton te jete mbyllur procesi I vleresimit te ofertave nga KVO dhe ku operatori ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK rezulton te jete i kualifikuar, vertetuar kjo edhe permes kerkeses qe autoriteti kontraktor i ka derguar ne SPE operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK me date 15.05.2024, duke e cilesuar si operator ekonomik te renditur i pari dhe per kete fakt duhej te dorezonte dokumentacionin e kerkuar ne autoritet kontraktor para publikimit te njoftimit te fituesit. Nga KPP eshte gjetur e gabuar, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit ne rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi ne respektim te dispozitave te sipercituara autoriteti pas perfundimit te vleresimit te ofertave dhe dergimit te klasifikimit perfundimtar operatoreve ekonomike pjesemarres i ka kerkuar ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat iae, ibe, ide, idhe, iee, ihe, iie, ije te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.02.2021 i per miratimin e rregullave te prokurimit publik e i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike, por qe nuk mund te rivleresonte edhe njehere dokumentet e dorezuara ne rruge elektronike me qellim verifikimin e permblushjes se kriterëve per kualifikim, pasi per kete fakt KVO e autoriteti kontraktor ishte shprehur njehere me date 16.05.2024 dhe ku statusi I operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK rezultonte i kualifikuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se percaktimi i procedurave dhe afateve te caktuara procedurale ne LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati per pergatitjen e ofertes, afati i shqyrtimit te ofertave, afati i ankimit etj, perfaqesojne garanci dhe siguri juridike per palet e interesuara. Parimi i ligjshmerise eshte nder parimet kryesore te veprimtarise se organeve te administrates publike.

Gjithashtu, nder parimet kryesore te zhvillimit te procedurave te prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, ne nenin 2 te tij, jane ato te mosdiskriminimit, transparences dhe barazise. Teresia e elementeve te mesiperme lidhet ngushtesisht me elemente te ligjshmerise se vendimeve te organeve te administrates publike.

Ndaj KPP ka gjykuar, se keto vendime jane ne kundershtrim me hapat procedurale qe parashikon LPP, ndaj keto vendime duhet te anulohen si vendime te dala ne kundershtrim me ligjin per prokurimin publik.

AK duhet te pershtatet me vendimet e KPP dhe te veproje ne zbatim te tyre.

2. Referuar arsyes se dyte te skualifikimit nuk PERMBUSH KRITERIN 2.3.5 TE PERCAKTUAR NE DST, KONKRETISHT KATALOG OSE SKEDE TEKNIKE TE SECILIT IMPIANT. SIPAS DST O.E DUHET TE DISPONOJE DOKUMENTAT E MEPOSHTME PROVUESE: a) DOKUMENTACIONIN PER VERTETIMIN E PRONESISE, HUAPERDORJES OSE TE MARRJES ME QERA TE PAJISJES (KU AFATI I MARRJES ME QERA/PERDORIMIT TE JETE MINIMALISHT ME AFATIN E EKZEKUTIMIT TE KETIJ OBJEKTI PROKURIMI);

B) TE JENE TE PASQYRUAR NE AKT MIRATIMET E LESHUARA NGA MINISTERIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT TE PARAQITURA NE PERMBUSHJE TE KRITERIT 2.1.1 DHE 2.1.2 ME SIPER;

C) KATALOG OSE SKEDE TEKNIKE OSE CDO DOKUMENT TJETER TEKNIK I SECILIT IMPIANT DHE MAKINERISE;

D) DEKLARATE KONFORMITETI CE I SECILIT IMPIANT DHE makinerisee.

Sqarojme sa me poshte vijon :

Autoriteti kontraktor i ka derguar mesazh ne SPE operatorit ekonomik iv.A.L.E. Recyclinge SHPK, me date 15.05.2024, duke e cilesuar si operator ekonomik te renditur i pari dhe per kete fakt duhej te dorezonte dokumentacionin e kerkuar ne autoritet kontraktor para publikimit te njoftimit te fituesit, dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat iae, ibe, ide, idhe, iee, ihe, iie, ije te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.02.2021 iper miratimin e rregullave te prokurimit publik e i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike.

Operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling sh.p.k., brenda afatit 5 ditor te percaktuar ne njoftimin e dates, dhe konkretisht me ane te shkreses se protokolluar prane AK, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore me nr. 2069 prot., date 20.05.2024, ka dorezuar dokumentat provuese te parashikuara ne shkronjat iae, ibe, ide, idhe, iee, ihe, iie, ije te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.02.2021 iper miratimin e rregullave te prokurimit publike i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike.

Ne dokumentat e dorezuara me ane te shkreses se protokolluar prane AK, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore me nr. 2069 prot., me date 20.09.2024, jane dhe dokumentat e meposhtme :

Numri rendor 21 dhe 22 te shkreses nr. 2069 prot., me date 20.09.2024, jane dukumentat per vertetimin e pronesise, kataloget dhe deklaratat e konformitetit te noterizuara si dhe jene te pasqyruar ne akt miratimet e leshuara nga ministria e turizmit dhe mjedisit te paraqitura ne permbushje te kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 dhe te vleresuara si te vlefshme dhe ne permbushje te kriterëve ne vleresimin e dates 16.05.2024.

AK nuk eshte shprehur konkretisht se per cilen nga makinerite nuk eshte paraqitur dokumentacioni konkret duke qene se keto dokumenta jane dorezuar dhe pranuar nga AK duke qene se ne kerkesen per sqarim te dates 21.05.2024 eshte kerkuar sqarim vetem per 1 impiant NEWSTER NË 15.

3. GJITHASHTU, STERILIZUESI NEËSTËR NË 15 NUK ESHTË I PERFESHIRE NE AKT MIRATIMET E LESHUARA NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT ME ARSYETIMIN E OPERATORIT EKONOMIK QE MEQENESE ESHTË IMPIANT BACK UP DHE NUK PERDORET NJEKOHESISHT ME STERILIZUESIN KRYESOR NUK ESHTË E NEVOJSHME TE PERFSHIHET NE AKT MIRATIMIN E LEJES MJEDISORE PERKATESE. KVO GJYKON SE NE BAZE TE LIGJIT NR. 10081 DATE 23.02.2009 eper LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE R.she NENI 27 PAVARESISHT SE PREK APO JO KRITERET E LICENCIMIT/LEJIMIT, KY OPERATOR EKONOMIK DUHET TE PAJISËT ME TITULLIN E NDRYSHUAR. NE VIJIM TE KETIJ ARSYETIMI, KVO GJYKON SE KY KRITER NUK PERMBUSHËT NGA ANA E O.E.

Siç është deklaruar edhe në formularin e vetdeklarimit, shtojca 9, pika B, OE disponon 2 impiante

*Sterilizues model NEWSTER NË 15, teknologji për të cilën është pajisur me miratimet përkatëse leje mjedisore e kategorisë III.1.B dhe licence III.2.B. Në formularin e vetdeklarimit, shtojca 9, pika B është deklaruar e...*1 impiant i përfshirë në lejen mjedisore PN-9488-03-2015, Nr. I identifikimit të Lejes 1780/3, dhe në licencën me nr. LN-5608- 07-2018, Nr. Lidentifikimit 274/1e, për të cilin autoriteti kontraktor është shprehur duke e kualifikuar operatorin e ekonomik me vlerësimin e datës 16.05.2024 dhe për këtë pikë vlen arsyetimi i bërë në pikën 1 të skualifikimit. Siç e kemi deklaruar edhe në formularin e vetdeklarimit, shtojca 9, pika B, OE disponon 2 impiante sterilizues model NEWSTER NË 15, teknologji për të cilën është pajisur me miratimet përkatëse leje mjedisore e kategorisë III.1.B dhe licence III.2.B. Në formularin e vetdeklarimit, shtojca 9, pika B është deklaruar e...*1 impiant i përfshirë në lejen mjedisore PN-9488-03-2015, Nr. I identifikimit të Lejes 1780/3, dhe në licencën me nr. LN-5608- 07-2018, Nr. Lidentifikimit 274/1. Ndërsa impianti tjetër do të përdoret vetëm impiant back up (në rast defekti të impiantit kryesor).*

Pra, impianti back up shërben për zëvendësimin e impiantit kryesor i të njëjtes teknologji në rastetë defekteve të ndryshme, siç sqaruar në formularin e vetdeklarimit të ngarkuar në SPE në momentin e zhvillimit të procedurës.

Referuar me sipër kryerja e procesit teknologjik (asgjësim / sterilizim në rastin tone) duke zëvendësuar impiantin ekzistues me një impiant tjetër me të njëjten teknologji si edhe fakti që impiantet nuk përdoren të 2 njëkohësisht, nuk janë ndryshime që prekin kriteret e licencimit/lejimit siç përcaktohet në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë.

Për më tepër në formularin e vetdeklarimit është përcaktuar se nëse ndonjë nga pajisjet nuk pranohet ose nuk konsiderohet si e vlefshme do të vlejë sipërfaqja e magazinimit duke qenë se AK i ka lënë si alternativë të njëra tjetër.

4. Referuar arsyes se kater të skualifikimit të persës I PERKET NDRYSHIMIT TE EMRIT TE NJE PREJ PAJISJEVE/IMPIANTIT ËFS-50, KVO KA SHQYRTUAR DOKUMENTACIONIN: DEKLARATE DOGANORE DATE 05.03.2024 PËR INCINERATORIN ZMFS-50, DEKLARATËN E KOMPANISË PRODHUESË PËR NDRYSHIMIN E MODELIT NGA WFS-50 NË ZMFS-50 NË DATE 14.12.2023 SI DHE TË DHENAT TEKNIKE TË INCINERATORIT

ZMFS-50 TE CILAT NUK KORRESPONDOJNE ME TE DHENAT E INCENERATOREVE PER TE CILET O.E ESHTË PAJISUR ME LEJE MJEDISORE TE TIPIT

A. DEKLARATA E KONFORMITETIT ESHTË LESHUAR PER ZMFS-50 DHE JO PER IMPIANTET QE O.E KA DEKLARUAR NE SHTOJCEN 9.

DUKE PASUR PARASYSH FAKTIN SE NE DST ESHTË KERKUAR : TE JENE TE PASQYRUAR NE AKT MIRATIMET E LESHUARA NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT TE PARAQITURA NE PERMBUSHJE TE KRITERIT 2.1.1 DHE 2.1.2, O.E KA DESHTUAR TE PROVOJE DHE DOKUMENTOJE SE INCENERATORI ZMFS-50 I CILI ESHTË ZHDOGANUAR ME DATE 05.03.2024 NGA KINA ESHTË I PERFESHIRE NE LEJEN MJEDISORE TE TIPIT A PASI KVO GJYKON SE NE BAZE TE LIGJIT NR. 10081 DATE 23.02.2009 eper LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE R.she NENI 27 PAVARESISHT SE PREK APO JO KRITERET E LICENCIMIT/LEJIMIT, KY OPERATOR EKONOMIK DUHET TE PAJISËT ME TITULLIN E ndryshuare.

Ne fomularin e vetdeklarimit i cili eshte vleresuar dhe kosideruar i rregullt ne vleresimin e date

16.05.2024, referuar inceneritorit, eshte deklaruar i2. Inceneritor ËFS-50* ñ cope 2.

Rrymat e mbetjeve qe trajton, referuar kodeve sipas VKM Nr. 402, date 30.6.2021 i per miratimin e katalogut te mbetjeve : 18 01 02, 18 01 08*. 18 01 09.

Impiante te perfshire ne lejen mjedisore PN-8024-01-2019, Nr. I identifikimit te Lejes 2929/2, dhe

Ne licencen me nr. LN-6809-03-2019, Nr. Lidentifikimit 307/1.

*deklarate prodhuesi date 14/03/2023 mbi njehsimin e modelit te pajisjes se zevendesuar.e

Ne dokumentat e dorezuara me ane te shkreses se protokolluar prane AK, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore me nr. 2069 prot., me date 20.09.2024, eshte dorezuar dhe vertetimi i leshuar nga prodhuesi i dates 14 Dhjetor 2023 ku deklaroi modelin i inceneratorit ZMFS -50 eshte i njejt i (ne parimin e ndertimit, teknologjise, funksionit dhe punnes) me modelin ËFS -50. Per shkak se kompania prodhuese ka ndryshuar emrin e saj, ajo ka ndryshuar gjithashtu edhe emertimet e pajisjeve qe prodhon. endryshimi i emrit te nje prej pajisjeve / impianteve te instaluar me teknologji apo proces te njejte per te cilen jemi pajisur me miratimet perkatese sikurse jane lejet mjedisore e kategorise III.1.C dhe Licence e kategorise III.2.B, nuk jane ndryshime qe prekin kriteret e licencimit/lejimit siç percaktohet ne Ligjin Nr.10 081, date 23.2.2009 i per licencat, autorizimet dhe lejet ne republiken e shqiperisee.

AKM me shkresen e derguar KPP dhe OE V.A.L.E. Recyclinge, me nr.5268/1 prot., date 17.05.2024 me lende i kthim pergjigjee dhe me ane te shkreses nr.5080/1 date 15.05.2024, drejtuar

QKB, MTM dhe dhe V.A.L.E Recyclinge ka konfirmuar faktin se operatori ekonomik nuk ka asnje shkelje dhe disponon pasjisjet sipas lejes mjedisore per lejen mjedisore te tipit A.

Shkresat bashkelidhur.

5. Referuar arsyes se peste te skualifikimit ñne BAZE TE VERIFIKIMEVE TE KRYERA NGA KVO NE QKB (URDHER NR,141 DATE 04.04.2024 eper PEZULLIMIN E LEJES MJEDISORE PER SUBJEKTIN VALE RECYCLING SHPK), SI DHE DOKUMENTACIONIT QE O.E KA VENDOSUR NE DISPOZICION NEPERMJET SPE, (KORRESPONDENCES MIDIS KOMISIONIT TE PROKURIMIT PUBLIK DHE AGJENSISE KOMBETARE TE

MJEDISIT ME NR.5268/1 PROT DATE 17.05.2024) PROCESVERBALIT TE VIZITES NE TERREN TE KVO date 13.05.2024, SI DHE KORRESPONDENCES MIDIS AKM DHE O.E REZULTON SE:

GJATE VERIFIKIMIT NE TERREN TE KVO DATE 13.05.2024, INCENERATORI ËFS-50 ISHTE NE PUNE DUKE KRYER PROCESIT E INCENERIMIT, PROVUAR KJO ME ANE TE PROCESVERBALIT DHE FOTO, VIDEO TE KVO-SE NE VEND. NGA ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT TE PARAQITUR NGA VET O.E, AKM CITON NDER TE TJERA SE NE PROCESVERBALIN E INSPEKTIMIT DATE 25.04.2024, INCENERATORET ËFS -50 DHE ZMFS -50 NUK ISHIN NE PUNE PER EFEKT TE ZBATIMIT TE URDHERIT 141 DATE 04.04.2024. NGA ANA E O.E NUK NA ESHTË VENE NE DISPOZICION VENDIM GJYKATE PER MAKINERITE DHE PAJISJET E CILA ISHTE OBJEKT KERKESË NEPERMJET SPE. NE RAST SE O.E DISPONONTE PROVA QË TREGOJNE SE LICENCA E TIJ NUK ISHTE E PEZULLUAR ME VENDIM GJYKATE DUHEJ TJA PROVONTE KVO (REFERUAR VENDIMIT NR.80-2024-1075 DATE 17.04.2024 PER PRANIMIN E KERKESËS PER MARRJEN E MASES SE SIGURIMIT, CITUAR NE SHKRESEN 5080/1 PROT, DATE 15.05.2024 TE AKM-SE) THEKSOJME SE O.E KA BARREN E PROVES TE PROVOI ME DOKUMENTACION SE PERMBUSH TE GJITHA KUSHTET E PERCAKTUARA NE dste, Kundeshtojme si me poshte :

Theksojme dhe nje here, operatori ekonomik V.A.L.E Recyclinge nuk ka dhe nuk ka pasur asnje Licence te pezulluar.

Operatori ekonomik ka marre pjese ne kete procedure pa pasur asnje pengese ligjore, pse duhet te deklaronte apo te vinte ne dispozicion dokumenta per te shkuaren kur ne te tashmen nuk ka asnje

Pengese ligjore?

Nese Autoriteti kontraktor pretendon te kunderten, pra qe ka pengesa ligjore nga V.A.L.E Recycling per te marre pjese ne kete procedure, eshte po vete institucioni qe duhet te vertetoje dhe ka barren e proves ta vertetoje ate cka pretendon.

AKM me shkresen e derguar KPP dhe OE V.A.L.E. Recyclinge, me nr.5268/1 prot., date 17.05.2024 me lende ikthim pergjigjee dhe me ane te shkreses nr.5080/1 date 15.05.2024, drejtuar

QKB, MTM dhe dhe V.A.L.E Recyclinge ka konfirmuar faktin se operatori ekonomik nuk ka asnje shkelje dhe disponon pasjesisjet sipas lejes mjedisore per lejen mjedisore te tipit A. Shkresa te cilat i jane vene ne dispozicion AK ne pergjigje te kerkeses per sqarim te derguar operatorit ekonomik.

PERSA I PERKET SPECIFIKIMEVE TE KONTENITOREVE TE MBETJE TE DIAPAZONIT 3-12 LITRA TE PERKTHYERA DHE TE NOTERIZUARA KVO GJYKON SE NUK E PERMBUSH SKEDEN TEKNIKE PER KONTENITORET C5 SB PASI PERKTHIMI ESHTË KONTRADIKTOR (SHKRUEHET VELLIM 40LT DHE KAPACITET 5 LT) DHE NGA VERIFIKIMI I KRYER NE MINISTRINE E DREJTËSISE NUK REZULTON NE LISTEN ZYRTARE E EKSPERTEVE(PERKTHYESVE ZYRTARE TE GJUHES ITALIANE) PRA KY SPECIFIKIM NUK KONSIDEROHET I PERMBUSHUR NGA ANA E KVO-SE.

Dhe per kete pike vlen arsyetimi i pikes 1 duke gene  se momenti procedural i kerkimit te dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor per permbushjen

e kritereve te pergjithshme dhe te veçanta te kualifikimit (jo dokumentacioni i deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit) per operatorin ekonomik iv.A.L.E Recyclinge SHPK, duhet te ishte data 16.05.2024, date ne te cilen referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton te jete permyllur dhe procesi i vleresimit te ofertave nga ana komisionit te vleresimit te ofertave(Vendimi KPP nr. 476/2024). Per me tej referohuni kundershimeve te pikes 1 te skualifikimit.

Shenim: ne faqen zyrtare te ministrise se Drejtesise gjendet lista e perkthyesve zyrtar ku ne liste gjejme dhe perkthyesin A.G.J. E pretendenduar nga ju qe nuk ndodhet ne listen e perkthyesve te licensuar, ne linkun <https://www.drejtesia.gov.al/perkthyesit/>.

PERSA I PERKET MAGAZINIMIT TE MBETJEVE PER KVO NUK ESHTË BINDESE HAPESIRA E VENDOSUR NE DISPOZICION PER MAGAZINIM NE RAST DEFEKTI TE IMPIANTIT KRYESOR, PASI NESE NDODH KY DEFECT, DO TE KRYHET MAGAZINIMI TE GJITHA MBETJEVE TE RREZIKSHME TE TE GJITHE SPITALEVE/SUBJEKTEVE ME TE CILET OPERATORI KA KONTRATE AKTIVE SIPAS SHTOJCES SE DST DATE 03.04.2024 (SHTOJCE E CILA NUK ESHTË OBJEKT ANKIMIMI NGA ANA E OPERATOREVE EKONOMIKE)

Pas verifikimit te dok ne SPE dhe verifikimit ne terren AK u bind qe siperfaqja e vendosur ne dispozicion ishte e mjaftueshme, me vleresimin e dates 16.05.2024, ndersa ne rivleresimin e dates

28.05.2024 AK u Çbind...

Dhe per kete pike vlen arsyetimi i pikes 1 duke qene ise momenti procedural i kerkimit te dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor per permbushjen e kritereve te pergjithshme dhe te veçanta te kualifikimit (jo dokumentacioni i deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit) per operatorin ekonomik iv.A.L.E Recyclinge SHPK, duhet te ishte data 16.05.2024, date ne te cilen referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton te jete permyllur dhe procesi i vleresimit te ofertave nga ana komisionit te vleresimit te ofertave. Gjithashtu dhe verifikimi i ambjenteve ne terren eshte bere perpara vleresimit te dates 16.05.2024, pra pjese e vleresimit te kesaj date. Per me tej referohuni kundershimeve te pikes 1 te

Skualifikimit.

Per sa me lart kundershime kerkojme kualifikim e ofertes se shoqerise iv.A.L.E. Recyclinge sh.p.k, duke qene te gjitha veprimet e autoritetit kontraktor jane bere ne kundeshitim te dispozitave ligjore ne fuqi, lidhur me momentin procedural te verifikimit te dokumentacionit origjinal ne shkelje te afateve ligjore.

Per te gjitha pikat e ankesave konstatohet i njejti igabime(mosrespektim te dispozitave ligjore ne fuqi, lidhur me momentin procedural te verifikimit te dokumentacionit origjinal ne shkelje te afateve ligjore), dhe pse arsyetimi dhe interpretimi ligjor i autoriteti kontraktor idrejtoria e Spitalit Rajonal Vloree eshte rrezuar nga KPP ne vendimet Nr. 276/2024, Nr. 286/2024 dhe Nr. 476/2024.

Per sa me lart, kerkojme qe te nisin hetimet administrative ndaj anetare te KVO duke qene se edhe

Pas disa vendimeve KPP te sipercituara dhe terheqjes se vemendjes nga KPP, per mosrespektim te dispozitave ligjore ne fuqi, lidhur me momentin procedural te verifikimit te dokumentacionit origjinal ne shkelje te afateve ligjore, vazhdojne te bejne te njejtat shkelje te perseritura te cilat tashme quhen te qellimshme dhe te demshme sepse demtojne operatorin ekonomik dhe vete autoritetin kontraktor ne zgjatjen procedurave, cka prodhojne kosto si per operatoret ekonomik dhe per vete autoritetin kontraktor.

Dokumentet e cituara bashkelidhur.

II.7.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1427/2 prot., datë 05.06.2024, duke publikuar duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7.3. Me anë të shkresës Nr.2307 prot., datë 05.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1427/3 prot., datë 06.06.2024, me objekt “*Informacion për procedurën me objekt: Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, për nevoja të SRV – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vjeçar (24 muaj). Fondi limit: 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) Lek pa Tvsh me Nr. Ref-93267-01-17-2024*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.8. Me shkresën nr. 1256/5 prot., datë 28.05.2024, me objekt “*Kërkesë për Informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, si më poshtë vijon:

Më datë 04.04.2024, me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 141, datë 04.04.2024, është urdhëruar pezullimi i lejes mjedisore PN-8024-01-2019 me veprimtari “Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerimi i mbetjeve patologjike”, me vendndodhje Fshati Gurëz, afër ish kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Laç, deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit”. Bashkelidhur ankesës së depozituar nga ky subjekt ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndodhet edhe Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Nr.Regj.Them. 97[300004-03173-80-2024], me datë regjistrimi 11.04.2024, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit admisnitrativ nr. 1997/5, datë 04.04.2024, të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit”. Nëpërmjetë këtij vendimi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

- 1. Pranimin e kërkesës për marrje mase sigurim padie.*

2. *Pezullimin e zbatimit të aktit administrativ urdhri nr. 141, datë 04.04.2024 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative.*

Për sa më sipër cituam, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon informacion nga ana juaj, nëse ky vendim për marrjen e masës së sigurimit të padisë është i ankimuar brënda afateve ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Nëse po, kërkojmë të na provoni (nëpërmjet akteve provuese), procedurën e ankimuar në Gjykatë nga ju.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, ju lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.9. Me shkresën nr. 1256/6 prot., datë 28.05.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik, si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, po shqyrton ankesën me nr. 1256/2024 prot, datë 21.05.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me REF-94567-02-06-2024, me objekt “Eliminim i Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore”, me fond limit 12,324,510 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 03.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë, me operator ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” SHPK. Bazuar në nenin 115 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na informoni në lidhje me aplikimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” SHPK, pranë institucionit tuaj, si më poshtë vijon:

- 1- *A ka aplikuar pranë jush, para datës 03.05.2024, subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK, për t’u pajisur me vërtetim, që ky operator nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit? Nëse po, kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit, mbi datën dhe nr. prot të kërkesës së administruar nga ana juaj.*
- 2- *Nëse subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK, ka aplikuar pranë jush para datës 03.05.2024, për t’u pajisur me këtë vërtetim, a janë marrë masa nga ana juaj, për t’i kthyer përgjigje këtij operatori ekonomik? Nëse po, kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit, mbi datën dhe nr. prot të shkresës nëpërmjet së cilës ju i keni kthyer përgjigje këtij subjekti, së bashku me një kopje të shkresës të njëhësuar me origjinalin nga zyra e protokollit.*

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, ju lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.10. Me shkresën nr. 5896/1 prot., datën 31.05.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit të Publik me shkresën nr. 1256/9 prot, datë 03.06.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik kthim përgjigjia e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1256/6 prot, datë 28.05.2024, regjistruar në AKM me nr. 5896 prot, datë 30.05.2024 ju bëjmë me dije se subjekti “Vale Recycling” SHPK ka paraqitur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kërkesat: 1- Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4391., prot, datë 23.04.2024; 2- Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4392 prot, datë 23.04.2024; 3- Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4393 prot, datë 23.04.2024;. Me shkresën nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, AKM ka kthyer përgjigje kërkuarit.

Nr. 4391/1 prot.

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Tiranë, më 29.04.2024

Lënda: Kthim përgjigje

V.A.L.E RECYCLING
Lezhë, Fushë Kuqe, Gurëz, afër ish-Kanalit të Acidit

Në përgjigje të shkresave, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me nr.4391 Prot, 4392 Prot, 4393 Prot datë 23.04.2024, me lëndë “Kërkesë”, ju bëjmë me dije se:

Pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në zyrën e **Protokoll-Arkivit**, për subjektin “V.A.L.E RECYCLING” gjatë vitit 2023 dhe 2024, për Lejen e Mjedisit tipi A me PN 8024-01-2019, Lejen e Mjedisit Tipi B me PN-9488-03-2015 si edhe Lejen e Mjedisit Tipi B me PN-4736-01-2013 janë protokolluar “Raportet Periodike të Zbatimit të Kushteve të Lejes Mjedisore” si më poshtë vijon:

- Leje Mjedisit Tipi A me PN-8024-01-2019
 - Tetor 2022-Janar 2023 (Shkresa.Nr. 988 Prot,datë 13.02.2023)
 - Janar 2023 - Prill 2023 (Shkresa. Nr. 3699 Prot, datë 17.05.2023)
 - Prill 2023- Korrik 2023 (Shkresa.Nr. 6229 Prot. datë. 14.08.2023)
 - Korrik 2023-Tetor 2023 (Shkresa Nr. 9421 Prot, datë 13.11.2023)
 - Janar 2022-Janar 2023 (Shkresa.Nr. 988 Prot, datë 13.02.2023)
 - Tetor 2023-Janar 2024 (Shkresa Nr. 1377 Prot, datë 08.02.2024)
 - Janar 2023-Janar 2024(Shkresa Nr. 1377 Prot, datë 08.02.2024)
- Leje Mjedisit Tipi B me PN-9488-03-2015
 - Shtator 2022-Mars 2023 (Shkresa Nr. 3011 Prot, datë 19.04.2023)
 - Mars 2023-Shtator 2023 (Shkresa Nr. 8518 Prot, datë 12.10.2023)
 - Mars 2022- Mars 2023 (Shkresa. Nr. 3011 Prot, datë. 19.04.2023)
 - Shtator 2023-Mars 2024 (Shkresa Nr.4213 Prot, datë 16.04.2024)
 - Mars 2023-Mars 2024 (Shkresa Nr.4213 Prot, datë 16.04.2024)
- Leje Mjedisit Tipi B me PN-4736-01-2013
 - Shtator 2022-Mars 2023 (Shkresa Nr. 2905 Prot, datë 19.04.2023)
 - Mars 2023-Shtator 2023 (Shkresa Nr. 8519 Prot, datë 12.10.2023)
 - Mars 2022- Mars 2023 (Shkresa Nr. 2905 Prot, datë. 19.04.2023)
 - Shtator 2023-Mars 2024 (Shkresa Nr.4214 Prot, datë 16.04.2024)



Mars 2023-Mars 2024 (Shkresa Nr.4214 Prot, datë 16.04.2024)

Në lidhje me detyrimet konfirmojmë se subjekti "V.A.L.E RECYCLING" nuk ka detyrime.

Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin "e-Inspektimi" rezulton se:

- Leje Mjedisi Tipi A me PN-8024-01-2019
Leja mjedisit e sipërcituar është e pezulluar referuar Urdhërit të Ministrit nr. 141, datë 04.04.2024 për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin "V.A.L.E Recycling" sh.p.k, me PN-8024-01-2019, me veprimtari "INCENERIMI I MBETJEVE TË RREZIKSHME NË NJË INSTALIM INCENERIMI. INCENERIMI I MBETJEVE PATOLOGJIKE".
- Leje Mjedisi Tipi B me PN-9488-03-2015
Nga verifikimi në sistemin "e- Inspektimi" nuk rezulton të ketë masë administrative.
- Leje Mjedisi Tipi B me PN-4736-01-2013
Nga verifikimi në sistemin "e- Inspektimi" nuk rezulton të ketë masë administrative.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artur Dollani

II.11. Me shkresën nr. 1256/10 prot., datë 06.06.2024, me objekt "Kërkesë për Informacion", Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si më poshtë vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjetë shkresës nr. 1256/6 prot, datë 28.05.2024, Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga ana juaj si më poshtë vijon:

1. *A ka aplikuar pranë jush, para datës 03.05.2024, subjekti "V.A.L.E Recycling" SHPK, për t'u pajisur me vërtetim, që ky operator nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit? Nëse po, kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit, mbi datën dhe nr. prot të kërkesës së administruar nga ana juaj.*
2. *Nëse subjekti "V.A.L.E Recycling" SHPK, ka aplikuar pranë jush para datës 03.05.2024, për t'u pajisur me këtë vërtetim, a janë marrë masa nga ana juaj, për t'i kthyer përgjigje këtij operatori ekonomik? Nëse po, kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit, mbi datën dhe nr. prot të shkresës nëpërmjet së cilës ju i keni kthyer përgjigje këtij subjekti, së bashku me një kopje të shkresës të njëhësuar me origjinalin nga zyra e protokollit.*

Me shkresën nr. 5896/1 prot, datë 31.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1256/9 prot, datë 03.06.2024 Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon se:

Subjekti "V.A.L.E Recycling" SHPK ka paraqitur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kërkesat :

- 1- *Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4391 prot, datë 23.04.2024;*
- 2- *Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4392 prot, datë 23.04.2024;*
- 3- *Më datë 20.04.2024, e regjistruar në AKM me nr. 4393 prot, datë 23.04.2024;*

Me shkresën nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, AKM ka kthyer përgjigje kërkuarit.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues (fotokopje të librit të dorëzimit pranë shërbimit postar ku të evidentohet data e dorëzimit pranë shërbimit postar të shkresës nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, dërguar nga ana juaj operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, së bashku me kodin e gjurmimit të postës shqiptare, si dhe çdo dokument tjetër provues që vërteton datën e marrjes në dorëzim nga ana e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK të shkresës suaj nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, ju lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.12. Me shkresën nr. 3669/1 prot., datën 10.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1256/12 prot, datë 11.06.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik kthim - përgjigjia e Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit është depozituar shkresa me nr. 1256/5 prot, datë 28.05.2024, protokolluar në Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit me nr. 3669 prot, datë 03.06.2024, ku kërkohet informacion dhe përcjellje të akteve provuese lidhur me procedurën e ankimit ndaj Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Nr. Regj.Them 97, datë regjistrimi 11.04.2024, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5, datë 04.04.2024, të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit”, me palë paditëse: “Vale Recycling” SHPK, ju sqarojmë se në zbatim të nenit 73 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrativeve i republikës së Shqipërisë”, ju përcjellim për njohje Ankimin e Vecantë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me ankues nga Avokatura e Shtetit pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit në vijimësi të procedurave sipas parashikimeve ligjore. Bashkalidhur gjeni Ankimin e Vecantë datë 13.05.2024”.

II.13. Me shkresën nr. 1256/13 prot., datë 13.06.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, si më poshtë vijon:

Nëpërmjet shkresës nr. 1256/5 prot, datë 28.05.2024, Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga ana juaj si më poshtë vijon:

Nëse Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Nr.Regj.Them. 97 [300004-03173-80-2024], me datë regjistrimi 11.04.2024, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit admisnitrativ nr. 1997/5, datë 04.04.2024, të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit”, është i ankimuar brenda afateve ligjore pranë Gjykatës Administative të Apelit Tiranë. Nëse po, kërkojmë të na provoni (nëpërmjet akteve provuese), procedurën e ankimuar në Gjykatë nga ju.

Me shkresën nr. 3669/1 prot, datë 10.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1256/12 prot, datë 11.06.2024 Ministria e Turizimit dhe Mjedisit informon se:

[...] Në zbatim të nenit 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ju përcjellim për njohje Ankimin e Veçantë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me ankues nga Avokatura e Shtetit pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, në vijimësi të procedurave sipas parashikimeve ligjore. Bashkëlidhur Ankimi i Veçantë datë 13.05.2024 [...].

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj informacion nëse është marrë vendim nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në lidhje me ankimin e veçantë të bërë nga ana juaj për Prishjen e Vendimit nr. 97 (300004-03173-80-2024) rregjistri datë 11.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për sigurimin e padisë dhe heqjen e masës si të pazuar në ligj e në prova. Nëse po ju lutem të na vini në dispozicion një kopje të vendimit sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës nga ana jonë.

II.14. Me shkresën nr. 6185/1 prot., datën 11.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1256/14 prot, datë 14.06.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik kthim - përgjigjia e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.1256/10 prot., datë 06.06.2024 me lëndë “Kërkesë për informacion” protokolluar me tonën Nr. 6185 prot., datë 10.06.2024, në të cilën kërkon informacion për subjektin “V.A.L.E Recycling” SHPK ju informojmë si më poshtë: 1- Për pyetjen, A ka aplikuar pranë jush, para datës 03.05.2024 subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK, për t'u pajisur me vërtetim, që ky operator nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ? Nëse po, kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit, mbi datën dhe nr. prot të kërkesës së administruar nga ana juaj, ju bëjmë me dije se: Subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK ka dorëzuar pranë protokollit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit para datës 03.05.2024 shkresat e mëposhtme: • Shkresa e protokolluar në AKM me Nr. 4391 prot., datë 23.04.2024 me lëndë “Kërkesë” (bashkëlidhur shkresa dhe faqja e librit të protokollit); • Shkresa e protokolluar në AKM me Nr. 4392 prot., date 23.04.2024 me lëndë “Kërkese” (bashkëlidhur shkresa dhe faqja e librit të protokollit); • Shkresa e protokolluar në AKM me Nr. 4393 prot., datë 23.04.2024 me lëndë “Kërkesë” (bashkëlidhur shkresa dhe faqja e librit të protokollit); 2- Për pyetjen, Nëse subjekti “V.A.L.E Recycling” SHPK, ka aplikuar pranë jush para datës 03.05.2024, për t'u pajisur me këtë vërtetim, a janë marrë masa nga ana juaj për ti kthyer përgjigje këtij operatori ekonomik ?

Nëse po kërkojmë të na provoni nëpërmjet librit të protokollit mbi datën dhe nr. prot të shkresës nëpërmjet së cilës ju i keni kthyer përgjigje këtij subjekti së bashku me një kopje të shkresës të njehësuar me originalin nga zyra e protokollit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit i ka kthyer përgjigje subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK me shkresën Nr. 4391/1 prot., datë 29.04.2024 me lëndë “Kthim përgjigje” (bashkëlidhur shkresa e njehësuar me origjinalin dhe fotokopje e librit të protokollit mbi datën dhe nr. e protokollit që i është kthyer përgjigje). Gjithashtu bashkëlidhur do të gjeni fotokopje të librit të dorëzimit në postën shqiptare në datë 30.04.2024 të shkresës Nr. 4391/1 prot., datë 29.04.2024 dërguar subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK dëftesën e marrë në Postën Shqiptare me kodin e gjurmimit si dhe gjurmimin e nxjerr nga Posta Shqiptare në bazë të KOD-BAR-it, për shkresën dërguar subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 1256/15 prot., datë 14.06.2024, me objekt “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Postës Shqiptare SHA, si më poshtë vijon:

Nëpërmjetë shkresës nr. 1256/10 prot, datë 06.06.2024, Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga ana Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si më poshtë vijon:

[...] Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues (fotokopje të librit të dorëzimit pranë shërbimit postar ku të evidentohet data e dorëzimit pranë shërbimit postar të shkresës nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, dërguar nga ana juaj operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, së bashku me kodin e gjurmimit të postës shqiptare, si dhe çdo dokument tjetër provues që vërteton datën e marrjes në dorëzim nga ana e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK të shkresës suaj nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024, ju lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur [...]

Me shkresën nr. 6185/1 prot, datë 11.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1256/14 prot, datë 14.06.2024 Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon se:

[...] Agjencia Kombëtare e Mjedisit i ka kthyer përgjigje subjektit “Vale Recycling” SHPK me shkresën Nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024 me lëndë “Kthim përgjigje” (bashkëlidhur shkresa e njehësuar me origjinalin dhe fotokopje e librit të protokollit mbi datën dhe nr. E protokollit që i është kthyer përgjigje. Gjithashtu bashkëlidhur do të gjeni fotokopje të librit të dorëzimit në postën shqiptare në datë 30.04.2024 të shkresës Nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024 dërguar subjektit Vale Recycling” SHPK deftesën e marrë në Postën Shqiptare me kodin e gjurmimit RR596226639AA [...].

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të

nevojshëm të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues që vërteton orën dhe datën se kur punonjësi i postës është paraqitur pranë zyrave të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për dorëzimin e objekti shkresën nr. 4391/1 prot., datë 29.04.2024, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit., me kod gjurmimi RR596226639AA.

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të paraqisni dokumentacionin e nevojshëm brenda 2 ditëve nga marrja në dorëzim e shkresës.

II.16. Me shkresën nr. 1258/1 prot., datën 20.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1256/17 prot, datë 21.06.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik kthim përgjigjia e Postës Shqiptare SHA me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1256/15, datë 14.06.2024 drejtuar Postës Shqiptare SHA nëpërmjet së cilës kërkon informacion mbi dorëzimin e objektit postar nr. 4391/1 prot, datë 29.04.2024 në adresë të subjektit “Vale Recycling” SHPK ju informojmë se objekti postar nr. 4391/1 prot, është dorëzuar pranë zyrës postare Tirana 8 (jashtë orarit zyrtar të grumbullimit të postës) në datën 30.04.2024. Objekti postar është procesuar me barkod RR596226639AA dhe është vijuar ditën e nesërme në datën 01.05.2024. Ky objekt ka mbërritur në zyrën postare Fush-Kuqe në datën 02.05.2024 dhe është dorëzuar kundrejt nënshkrimit të përfaqësuesit të subjektit “Vale Recycling” SHPK znj. O. T në datën 03.05.2024. Sqarojmë, se punonjësi i kësaj zyre postare nuk disponon pajisje dorëzimi me të cilën mund të përcaktohet orari i dorëzimit të postës”.

II.17. Me shkresën nr. 3669/3 prot., datën 20.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1256/18 prot, datë 24.06.2024, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kthim - përgjigjia e Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1256/13 prot, datë 13.06.2024, nëpërmjet së cilës kërkohet informacion nëse nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është marrë vendim, mbi ankimin e vecantë për sigurimin e padisë dhe heqjen e masës si të pabazuar në ligj, të bërë nga ana e Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, për subjektin “Vale Recycling” SHPK, ju bëjmë me dije se pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit nuk është depozituar apo njoftuar vendim mbi ankimin e vecantë për këtë proces. Ky fakt konfirmohet edhe nga Avokatura e Shtetit”.

II.18. Me shkresën nr. 1427/4 prot., datë 27.06.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, si më poshtë vijon:

Në datën 17.04.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit të kërkesës për marrje mase sigurimi të padisë së ankimuesit “V.A.L.E. Recycling” SHPK, vendosi:

- Pranimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie.*

- *Pezullimin e zbatimit të aktit administrativ urdhër nr. 141 datë 04.04.2024 të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative.*
- *Ti caktojë paditësit afatin 10 ditë brenda të cilit të depozitojë në sekretarinë e gjykatës padinë duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.*
- *Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda afatit 10 ditor masa e sigurimit shuhet.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*
- *U shpall në Tiranë sot më datë 17.04.2024.*

Sa më sipër, KPP ndodhur në këto kushte, duke qenë, se pranë institucionit tonë janë paraqitur disa ankesa nga operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” SHPK, për kundërshtimin e skualifikimit të tij në procedurat e prokurimit, për shkak të pezullimit të lejes së mjedisit të tipit A me PN-8024-01-2019, kërkojmë nga ana juaj të na informoni:

Së pari, a jeni vënë në dijeni në cilësinë e të paditurit, nëse operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” SHPK ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, për të kundërshtuar aktin administrativ urdhër nr. 141 datë 04.04.2024 të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit.

Së dyti, cili është statusi ligjor i lejes mjedisore PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 dhe me Kod III.1.C (), me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, deri në datë 03.05.2024 (datë kur janë zhvilluar këto procedura prokurimi).

II.19. Në datën 27.06.2024, me anë të shkresës me nr. 1427/5 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, ka vënë në dijeni palët se:

“Lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-93267-01-17-2024, me objekt “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, me fond limit 17,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: “5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët”, ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se për shkak të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.”

II.20. Me shkresën nr. 4303/1 prot., datën 02.07.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1427/6 prot, datë 03.07.2024, është depozituar pranë

Komisionit të Prokurimit Publik, kthim -përgjigjia e Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1427/4 prot., date 27.06.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit me nr. 4303 prot., date 28.06.2024, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion nëse jemi në dijeni në cilësinë e të paditurit që operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” shpk ka paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe cili është statusi ligjor i lejes mjedisore PN-8024-01-2019 me datë lëshimi 22.04.2024 me Kod III. 1.C, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Referuar komunikimeve tona zyrtare konkretisht shkresave me nr. 3669/1 date 10.06.2024 si dhe shkresës nr. 3669/3., datë 20.06.2024, ju bëjmë me dije se më date 14.05.2024 është depozituar pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit padia dhe aktet bashkëlidhur saj me paditës Shoqeria “V.A.L.E Recycling” shpk, me objekt: Shfuqizim akti administrativ. Më date 23.05.2024 Ministria e Turizimit dhe Mjedisit në cilësinë e të paditurit ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë prapësimet me shkrim, brenda afateve ligjore. Në lidhje me statusin ligjor të lejes mjedisore, ju bëjmë me dije së për Lejen Mjedisore PN- 8024-01-2019 me datë lëshimi 22.04.2024 me Kod III.1.C, me Urdhrin nr/1997/5 date 04.04.2024 është vendosur pezullimi i Lejes Mjedisore për subjektin “V.A.L.E Recycling” shpk, me veprimtari “Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme me një instalim incenerimi, incenerim i mbetjeve patologjike, me vendodhje fshati Gurrës, Fushë Kuqe, Lac, Lezhë. Bashkëlidhur gjeni Urdhrin nr/1997/5 date 04.04.2024”.

II.21. Me anë të shkresës nr. 1427/7 prot., datë 17.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, konkretisht si mëposhtë:

“[...] Me anë të shkresës Nr.2307 prot., datë 05.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1427/3 prot., datë 06.06.2024, me objekt “Informacion për procedurën me objekt: Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, për nevoja të SRV – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vjeçar (24 muaj). Fondi limit: 17 500 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) Lek pa Tvsh me Nr. Ref-93267-01-17-2024”, autoriteti kontraktor juaj ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK së bashku me

procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit, referuar arsyeve të skualifikimit të këtij operatori ekonomik.”

II.22. Me anë të shkresës Nr.2926 prot., datë 19.07.2024, protokolluar me tonë me nr. 1427/8 prot., datë 22.07.2024, me objekt “*Shkresë përcjellëse*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, të paraqitur pranë autoritetit kontraktor (585 faqe).

II.23. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të Ligjit për Prokurimin Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike: “[...] A. NE lidhje me menyren e zhvillimit të procedurave:

AK ka publikuar në SPE me date 16.05.2024 rezultatet e shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave dhe në vijim me date 28.05.2024 ka publikuar një vendim të ndryshëm për shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave.

Keto veprime të AK, janë në kundërshtim me nenin 97 (1) të LPP, ku përcaktohet se:

Menjehere, por jo me vonë se 5 dite pas përfundimit të procedurës së vleresimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatoreve ekonomike i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

Edhe nese KVO reflekton ndonje ndryshim ne rezultatin e vlresimit, kjo mund te ndodhe vetem per ato ceshtje qe pasqyrohen ne dokumentacionin fizik qe paraqitet nga ofertuesi i renditur i pari, ne zbatim te nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, i ndryshuar dhe jo per ofertat e ofertuesve te tjere mbi te njejtat dokumenta te dorezuara ne SPE qe jane vlresuar nje here.

B. NE lidhje me skualifikimin e ofertes sone:

Oferta jone eshte refuzuar pasi sipas KVO: inuk permbushni specifikimet e percaktuara ne Shtojcen 5, pasi ne Deklaraten per perdorimin e kontenitoreve njeperdorimesh qe do te perdoren per amballazhimin e mbetjeve spitalore i jeni drejtuar nje autoriteti tjeter kontraktor, Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik Koco Gloxheni, Tiranee

Ky qendrim i KVO eshte i pabazuar ne ligj dhe ne DST pasi:

Kriteri i percaktuar ne DST, ne lidhje me kontenitoret eshte kriteri 2.3.7. Qe percakton se:

2.3.7. Operatori duhet te furnizojte kontenitoret sipas standarteve dhe kerkesave te Specifikimeve Teknike dhe Termave te References. Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese per secilin lloj kontenitori:

? Katalog ose skede teknike

Pra, duket qarte se per permbushjen e ketij kriteri, AK ka kerkuar qe te paraqitet per seicilin lloj Kontenitori ikatalog ose skede teknikee NE permbushje te kesaj kerkesa nga ana jone jane paraqitur te gjithe skedat teknike per seicilin lloj kontenitori dhe konkretisht eshte depozituar ne SPE dokumentacioni si vijon (Aneks 4, 5, 6, 7, 8):

- 30 Skeda teknike kontenitor 3L-12L(me_kapak_te_kuq&bardhe)
- 31 Skede teknike kontenitor 40 L -60L
- 32 Skede teknike 40 L kontenitor i kuq
- 33 Skede teknike kontenitor kartoni 60L
- 34 Foto_kontenitore

Keto dokumenta, qe jane te vetmet te kerkuara nga AK per verifikimin e permbushjes se ketij kriteri vertetojne dhe permbushin plotesisht kerkesat e percaktuara nga AK ne DST. Deklarata te ciles i referohet KVO si shkak per refuzimin e ofertes, eshte nje dokument qe ne fakt nuk eshte kerkuar ne DST, por thjesht nje dokument shtese i dorezuar ne menyre fakultative nga ana jone.

NE kete kuptim, KVO duhet te kishte zbatuar nenin 92 (3) te KPP dhe te kishte ruajtur vlresimin e pare te ofertes sone si e vlefshme, pasi ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit dhe jo te bente rivlresim pa shkak, per me teper duke e skualifikuar oferten tone per shkaqe dhe/ose kerkesa qe nuk jane percaktuar ne DST.

Edhe sikur nje deklarate e tille te ishte kerkuar, serish, KVO nuk ka gjetur asnje specifikim apo kerkee qe nuk plotesohen, por thjesht i referohet nje lapsusi ne lidhje me AK te cilit i drejtohet deklarata, qe sidoqofte ne situaten hipotetike kur nje deklarate e tille do ishte kerkuar, do duhej te ishte konsideruar thjesht nje devijim minor.

Per me teper, gjithsesi plotesimi ne menyre te detajuar i specifikimeve teknike dhe termave te references nuk mund te verifikohet nepermjet deklaratave te OE, por nepermjet ndjekies dhe monitorimit te zbatimit te kontrates, pasi ajo eshte lidhur dhe ka filluar zbatimin e saj.” [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në datën 03.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 16.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “V.A.L.E Recycling” SHPK	13,125,055	kualifikuar
2. “Medi - Tel” SHPK	15,519,877.8	skualifikuar
3. “Eco Riciklim” SHPK	17,071,865.58	kualifikuar

III.1.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik, si informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se me datë 15.05.2024 në rubrikën “Kërkesa” në SPE autoriteti kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK kërkesën për paraqitjen e dokumentacionit në autoritet kontraktor me përmbajtje si vijon:

“Mbështetur në Vendimin Nr. 295, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, Pika 6 citon: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/ enti kontraktor duhet ti kërkojë ofertuesit fitues që ta dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. [...] afati për dorëzimin e dokumentave është 5 ditë nga momenti i vlerësimit elektronikisht. Data e vlerësimit të procedurës me objekt Ecadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore, për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë, është data 15.05.2024 [...]”..

III.1.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe informacioni i autoritetit kontraktor, rezulton se në datën 28.05.2024, pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, ka kyer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke rivlerësuar përsëri dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK.

1. “V.A.L.E Recycling” SHPK	13,125,055	skualifikuar
2. “Medi - Tel” SHPK	15,519,877.8	skualifikuar
3. “Eco Riciklim” SHPK	17,071,865.58	skualifikuar

III.1.6. Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“NUK PERMBUSHNI SPECIFIKIMET E PERCAKTUARA NE SHTOJCEN 5 PASI NE DEKLARATEN PER PERDORIMIN E KONTENITOREVE NJEPERDORIMSH QE DO TE PERDOREN PER AMBALLAZHIMIN E MBETJEVE SPITALORE I JENI DREJTUAR NJE AUTORITETI TJETER KONTRAKTOR SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK KOCO GLIOZHENI TIRANE”.

III.1.7. Në datën 29.05.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Anulimit të procedurës së prokurimit.

III.1.8. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.9. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.10. Në nenin 80 pika 1,2,3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”

III.1.11. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.12. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
- 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

III.1.13. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së

kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. *“Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

III.1.14. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, si dhe pretendimet e këtij të fundit, KPP vëren, se momenti procedural i vlerësimit të dokumentacionit mbi kriteret e kualifikimit, të dorëzuar në SPE, duhet të ishte data 16.05.2024, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton të jetë përmblyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave. Jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, KVO nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të ofertave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraparak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon, se brenda periudhës kohore që ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dipozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 16.05.2024, ku operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK rezulton i kualifikuar, çfarë do të thotë, se sipas vlerësimit të KVO-së së autoritetit kontraktor “Eco Riciklim” SHPK i ka përmbushur kriteret për kualifikim.

Ligjvënësi e ka parashikuar qartë në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, që në rastin e formuluarit përmbledhës të vetëdeklarimit bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti

kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

Për të gjithë dokumentet e tjera të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 16.05.2024, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t'u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre me kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e përcakton në mënyrë të qartë që një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo pëmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vlerësimin e datës 16.05.2024, ku operatori ekonomik "Eco Riciklim" SHPK rezultoi i kualifikuar. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t'u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave dhe vetëm në rastet e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE dhe që shërbejnë si provë paraprake vlerësimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkesore mund të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në rrugë shkesore.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se rivlerësimi i datës 28.05.2024 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues "Eco Riciklim" SHPK dhe akti administrativ për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra publikimit të njoftimit të anulimit, do të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme, pasi skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për mospërbushjen e një kriteri për të cilin me dokumentacionin e ngarkuar në sistem dhe sipas vlerësimit të kryer me datë 16.05.2024 nga ana e autoritetit kontraktor rezultonte si i përbushur, e bën atë absolutisht të pavlefshëm si veprim procedural. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikon se "*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*"

Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) *veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convallescere non potest)*. Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK, dhe publikimi i njoftimit të anulimit i datës 29.05.2024 të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor, janë akte administrative absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*”, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “Eco Riciklim” ShPK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat procedurale të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmyjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkalluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”.

Sa më sipër, KPP gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, në shkelje të afateve ligjore. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës

parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen skualifikimin e operatorit ekonomik ankimes, të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

III.1.15. Akoma më tej, në shtojcën datë 23.01.2024, të publikuar për modifikimin, e dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.7 e “Kapacitetit teknik”, parashikohet se:

2.3.7. *Operatori duhet të furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë për secilin lloj kontenitori:*

- *Katalog ose skedë teknike*

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Gjithashtu risjellim në vëmendje se:

- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes për keto pika do të jete kusht skualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht skualifikimi.*
- *KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe rezervon të drejtën e verifikimit në terren lidhur me funksionimin e proceseve të punës për pajisjet që do të paraqiten nga operatorët ekonomik.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.16. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit , në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

III.1.17. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik , konstatohet se operatori ekonomik “Eko Riciklim” SHPK ka dorëzuar:

- *Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku konstatohet se ka plotësuar Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.*

III.1.18. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eko Riciklim” SHPK se “Nuk përmbushni specifikimet e përcaktuara në shtojcën 5 pasi në deklaratën për përdorimin e kontenitoreve njëpërdorimsh që do të përdoren për ambalazhimin e mbetjeve spitalore i jeni drejtuar një autoriteti tjetër kontraktor spitalit universitar obstetrik-gjinekologjik koco gliozheni tirane”, gjykojmë se deklarata për përmbushjen e specifikime teknike, është pjesë e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Eko Riciklim” SHPK rezulton se ka plotësuar Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.

III.1.19. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në ofertën e tij “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” ku rezulton

se ka plotësuar Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, A: DEKLARATË “Në përputhje me specififikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar në asnjë moment që të paraqitet ndonjë dokument shtesë që provon se operatori ekonomik përmbushin specififikimet teknike apo kërkesa specifike lidhur me kontenitorët njëpërdorimësh. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin dokumenta shtesë apo deklarata që vërtetojnë se kontenitorët njëpërdorimësh janë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike: *“1. Referuar arsyes se pare te skualifikimit “SIPAS TE DHENAVE TE QKB, LICENCA JUAJ E TIPIT A ESHTË E PEZULLUAR. PERPOS KETIJ FAKTI, KVO GJATE KESAJ PERIUDHE KA VERIFIKUAR FAKTET SI ME POSHTEE, sqarojme :*

Se pari, vlen te theksojme se ne asnje moment operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” nuk ka pasur dhe nuk ka asnje licence te pezulluar.

Se dyti, nisur nga arsyeja e skualifikimit, operatori ekonomik gjen me vend te marre per baze arsyetimin e KPP nr. Nr. 476/2024, ndaj te njejtit autoritet kontraktor, dhe konstatojne se momenti procedural i kErkimit tE dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor per permbushjen e kriterëve te pergjithshme dhe te veçanta te kualifikimit i (jo dokumentacioni I deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit) per operatorin ekonomik V.A.L.E Recyclinge SHPK, duhet te ishte data 16.05.2024, date ne te cilen referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton te jete permyllur dhe procesi i vleresimit te ofertave nga ana komisionit te vleresimit te ofertave. Jo me kot ligjvenes, ne varesi te llojit te procedures, ka parashikuar nje afat kohor (20 ose 15 dite) per procesin e vleresimit te ofertave duke dhene garanci per secilen prej paleve, KVO nga njera ane per kryerjen e nje vleresimi te thelluar e transparent dhe me mundesine edhe te kryerjes se verifikimeve prane paleve te treta ose sqarimeve nga operatoret ekonomike sa here lind nevoja, dhe operatoreve ekonomike pjesemarrës qe pas procesit te vleresimit te oferave dhe publikimit te njoftimit te fituesit paraprak apo anulimit te procedures te kene mundesi te mbrojne interesat e ligjshem duke ushtruar te drejten e ankimit ne autoritet kontraktor dhe ne KPP.

Po ashtu duke ndjekur arsyetimin e KPP ne vendimin Nr. 476/2024 konstatojme, se Brenda periudhes kohore qe ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur ne dipozicion momentin procedural per kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve te nevojshme per permbushjen

e kritereve te pergjithshme apo te veçanta te kualifikimit, derisa te konkludonte me mbylljen e procesit te vleresimit ne sistemin e prokurimit elektronik te dates 16.05.2024, çfare do te thote, se sipas vleresimit te KVO-se se autoriteti kontraktor, operatori ekonomik i ka permbushur kriteret per kualifikim. Ligjvenesi e ka parashikuar qarte ne nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 iper miratimin e regullave te prokurimit publike i ndryshuar, qe ne rastin e formularit permbledhes te vetedeklarimit bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit në Nenin 82, te LPP se, dhe ne keto rregulla. Per te vazhduar me piken 6 te VKM-se se sipercituar ku parashikohet se “6. Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, ibe, ide, idhe, iee, ihe, iie, ije te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin. NE kete kuader pas dorezimit te dokumentacionit ne forme shkresore nga operatori ekonomik i kualifikuar, i pari sipas autoritetit kontraktor (referuar kjo e kerkeses se ketij te fundit drejtuar ne SPE operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK me date 15.04.2024) KPP gjykoi, se vetem per dokumentet e deklaruar ne formularin permbledhes tevetedeklarimit dhe qe kane sherbyer si prove paraprake, autoriteti kontraktor mund te shprehe vleresimin mbi perputhshmerine e tyre me ate qe operatori ekonomik ankimues ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE. Ndersa per te gjithë dokumentet e tjera te ngarkuara ne sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur ne dispozicion momentin procedural te vleresimit te dokumenteve ne SPE deri me date 16.05.2024, kur ka perfunduar procesi i vleresimit ne SPE dhe njoftimi i operatoreve ekonomike pjesemarrës mbi vleresimin per tûu shprehur ne lidhje me perputhshmerine e tyre me kriteret per kualifikim te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e percakton ne menyre te qarte qe nje oferte konsiderohet e vlefshme vetem nese ajo pembush te gjitha kerkesat per kualifikim, fakt te cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vleresimin e dates 16.05.2024, ku operatori ekonomik iv.A.L.E. Recyclinge rezulton i kualifikuar. KPP ka gjykuar, se ligjvenesi ka percaktuar nje procedure te caktuar per tûu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore ne procesin e vleresimit te ofertave dhe vetem ne rastet e deklarimeve te paraqitura ne formularin permbledhes te vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE dhe qe sherbejne si prove paraprake vleresimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorezuar ne rruge shkesore mund te verifikoje perputhshmerine e deklarimeve te paraqitura ne formularin permbledhes te vetedeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar ne rruge shkresore.

Ndersa ne rastin konkret duke vazhduar arszetimin e ndjekur nga KPP ne vendimin 476/2024, operatori ekonomik veren, se duhet te ishte data 16.05.2024 kur rezulton te jete mbyllur procesi I vleresimit te ofertave nga KVO dhe ku operatori ekonomik iv.A.L.E. Recyclinge SHPK rezulton te jete i kualifikuar, vertetuar kjo edhe permes kerkeses qe autoriteti kontraktor i ka derguar ne SPE operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK me date 15.05.2024, duke e cilesuar si operator ekonomik te renditur i pari dhe per kete fakt duhej te dorezonte dokumentacionin e kerkuar ne autoritet kontraktor para publikimit te njoftimit te fituesit. Nga KPP eshte gjetur e gabuar, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit ne rastin konkret nga

ana e autoritetit kontraktor, pasi ne respektim te dispozitave te sipercituara autoriteti pas perfundimit te vleresimit te ofertave dhe dergimit te klasifikimit perfundimtar operatoreve ekonomike pjesemarres i ka kerkuar ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat iae, ibe, ide, idhe, iee, ihe, iie, ije te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.02.2021 iper miratimin e rregullave te prokurimit publik e i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike, por qe nuk mund te rivleresonte edhe njehere dokumentet e dorezuara ne rruge elektronike me qellim verifikimin e permbushjes se kriterave per kualifikim, pasi per kete fakt KVO e autoriteti kontraktor ishte shprehur njehere me date 16.05.2024 dhe ku statusi i operatorit ekonomik V.A.L.E. Recyclinge SHPK rezultonte i kualifikuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se percaktimi i procedurave dhe afateve te caktuara procedurale ne LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati per pergatitjen e ofertes, afati i shqyrtimit te ofertave, afati i ankimimit etj, perfaqesojne garanci dhe siguri juridike per palet e interesuara. Parimi i ligjshmerise eshte nder parimet kryesore te veprimtarise se organeve te administrates publike.

Gjithashtu, nder parimet kryesore te zhvillimit te procedurave te prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, ne nenin 2 te tij, jane ato te mosdiskriminimit, transparences dhe barazise. Teresia e elementeve te mesiperme lidhet ngushtesisht me elemente te ligjshmerise se vendimeve te organeve te administrates publike.

Ndaj KPP ka gjykuar, se keto vendime jane ne kundërshtim me hapat procedurale qe parashikon LPP, ndaj keto vendime duhet te anulohen si vendime te dala ne kundërshtim me ligjin per prokurimin publik.

AK duhet te pershtatet me vendimet e KPP dhe te veproje ne zbatim te tyre”, Komisioni vëren se:

III.2.1. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të publikuar në datë 23.01.2024, në pikën 2.1. përcaktohet si më poshtë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2. Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", në VKM nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe në Termat e Referencës se DST, ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,

si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore)

që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;

- 18 01 04 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.).

4. Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);
- 18 01 08 - Medikamente citostatika dhe citotoksike;
- 18 01 09 - Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08

III.2.2. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të publikuar në datë 26.04.2024, në pikën 2.3.5. përcaktohet si më poshtë:

BEHET

Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makinerite e meposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se për miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e konteniereve të riperdorshem, si me poshte:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zëvendësues me të njëjten metode OSE AMBJENT MAGAZINIMI TE PERCAKTUAR EKSKLUZIVISHT PER MBETJET SPITALORE TE PRODHUARA NGA SRV, JO ME PAK SE 100 M² SIPAS KUSHTEVE TE RREGULLORES PER MBETJET SPITALORE.
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up ose zëvendësues me të njëjten metode OSE MAGAZINEN E SIPERPERMENDUR!
- c. Makineri për larjen e konteniereve cope 1 dhe makineri back up ose zëvendësues të tilla (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të riperdorshem);

Per të vertetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- e) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pojisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- f) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- g) Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerise;
- h) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

- i) Vetedeklarim mbi pronesine ose cdo Iloj posedimi te njohur ligjerisht mbi ambientin e magazines se mbetjeve e cila duhet te jete e shoqeruar me planimetri te leshuar nga organet kompetente (ne rastin kur o.e disponon magazine per mbetje si ekuivalent te impiantit te back up)
- j) Vetedeklarim mbi kontratat qe operatori ekonomik ka nenshkruar me kete objekt prokurimi me qellim verifikimin e disponueshmerise se hapesirave te magazinimit te mbetjeve spitalore nga ana e KVO-se (ne rastin kur o.e disponon magazine per mbetje si ekuivalent te impiantit te back up)

**Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e te dhenave konkrete per secilen pajisje (peryshire edhe ato back up), nepermjet formularit te vededeklarimit sipas shtojces 9 te DST, duke perfshire te dhenat si vijon: emertimi i impiantit/modeli/rrymat e mbetjeve qe trajton dhe/ose asgjeson/ Leja dhe Licensa perkatese ku jane te perfshire (nga ato te paraqitura ne permbushje te kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 me siper*

Sehnim nr.1:

KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per seicilen nga pajisjet sa me siper si dhe verifikimin e ambienteve te magazinimit kushtet dhe siperfaqen (duke perfshire verifikimin e hapsires se nevojshme per magazinim te mbetjeve spitalore te A.K dhe hapsires se kontratave te tjera aktive te operatorit)

Shenim nr.2:

Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla", si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin".

Persa i perket shkronjes i) arsyejme se:

Magazina e mbetjeve duhet te plotesoj te gjitha kriteret e rregullores per mbetjet spitalore. Siperfaqja e kerkuar prej 100 m² ekskluzivisht per Spitalin Rajonal Vlore eshte kerkuar duke perlogaritur mesatarisht sasine mbetjeve spitalore te prodhoar nga SRV per periudhen kohore 45 ditore. Konkretisht jane perlogaritur mesatarisht 495 kontenitor me permasa 40x32 cm si dhe ne respektim te pikes 8.6 te rregullores se siperpermendur duke lejuar hyrjen per qellime inspektimi dhe siperfaqet prej 20 m² per vendosjen e frigoriferve brenda kesaj hapsire, ne total 63 m²+18m²+20m² — 101 m.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi, plotësuar si mëposhtë:

1. Sterilizator NEWSTER NW15 – cope 2*.

Rrymat e mbetjeve që trajton, referuar kodeve sipas VKM Nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”: 18 01 01, 18 01 03*, 18 01 04.

*1 impiant i përfshirë në lejen mjedisore PN-9488-03-2015, Nr. i identifikimit të Lejes 1780/3, dhe në licencën me nr. LN-5608-07-2018, Nr. Identifikimit 274/1. Ndërsa impianti tjetër do të përdoret vetëm impiant back up (në rast defekti të impiantit kryesor) me të njëjtën metodë.

2. Inceneritor WFS-50* – cope 2.

Rrymat e mbetjeve që trajton, referuar kodeve sipas VKM Nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”: 18 01 02, 18 01 08*, 18 01 09.

impiante të përfshirë në lejen mjedisore PN-8024-01-2019, Nr. i identifikimit të Lejes 2929/2, dhe në licencën me nr. LN-6809-03-2019, Nr. Identifikimit 307/1.

*Deklaratë prodhuesi datë 14/03/2023 mbi njehsimin e modelit të pajisjes së zëvendësuar.

3. Kontenierë një përdorimësh, sipa skedave teknike dhe katalogeve të ngarkuar në SPE.

Pasuri e patundshme, me numër pasurie 10/104, lloji i pasurisë ndërtesë, me sipërfaqe 913.44 m², me adresë KURBIN, LAÇ, Rr.: FUSH-KUQE, në pronësi të shoqërisë V.A.L.E Recycling, nga të cilat **101 m² do të shërbejnë si magazinim ekskluziv** për mbetjet spitalore të gjeneruara nga Spitali Rajonal Vlorë (në rast se ndonjë nga pajisjet (inceneritor apo sterilizator) nuk vlerësohet si e përshtatshme nga AK, Spitali Rajonal Vlorë).

- Leje mjedisi PN-8024-01-2019 e tipit A me kod III.1.C dhe me emërtim përshkruar të veprimtarisë: Leje Mjedisi e Tipit A për: Incinerim i mbetjeve të rreikshme në një instaim incenerimi. Incenerim i mbetjeve patologjike.
- Akt Miratim Leje Mjedisi Tip A me nr. 3781 prot., datë 22.04.2022 me nr. Identifikimi të lejes 2929/2 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ku në Tabelën 1.1.2 – Lista e veprimtarive të lidhura me to, citohet: “*Impiantet janë të tipit ËFS – 50 dhe janë të instaluara 2 (dy) të tilla brenda objektit kapanon. Instalimi i tipit ËFS-50 ka sipërfaqe 2.7 m² (1.8m x 1.5m).*”
- Leje mjedisi PN-9488-03-2015 e tipit B me kod III.1.B dhe me emërtim përshkruar të veprimtarisë: Leje Mjedisi e Tipit B për: Asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme përveç

incenerimit ose lëndfillimit. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazhuarapaketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme;

- Akt - Miratim Leje Mjedisi Tip B me nr. 2421 prot., datë 06.04.2021 me nr. Identifikimi të lejes 1780/3 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. ku në Tabelën 1.1.2 – përshkrimi i veprimtarisë së specifikuar, citohet: *“Instalimet për trajtimin/ asgjësimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve spitalore: 1- Pajisja për trajtimin/asgjësimin e mbetjeve spitalore (TSC – 150 ECONOS); 2. Pajisja për trajtimin/ asgjësimin e mbetjeve spitalore Neëster NË15 [...]”*.
- Licence LN-6809-03-2019 me Kod III.2.B me emertim pershkruar të veprimtarsë: Grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve spitalore (nga kujdesi shëndetësor njerëzor dhe shtazor)
- Akt - Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. 4233 prot., datë 18.06.2020 me nr. Identifikimi të lejes 307/1 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.
- Licence LN-5608-07-2018 me Kod III.2.B me emertim pershkruar të veprimtarsë: Grumbullim, transport, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve spitalore.
- Akt - Miratim Licence e kategorise III.2.B me Nr. Identifikimi 274/1 me nr. 4684 prot., datë 07.07.2021 miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

III.2.4. Në nenin 2 *“Qëllimi”* të ligjit nr.162/2022 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Neni 3 *“Parime të përgjithshme”* të ligjit nr.162/2022 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar parashikon se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.6. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

III.2.7. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

III.2.9. Në nenin 1 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

III.2.10. Në nenin 2 “Objekti dhe fusha e veprimi” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Ky ligj përcakton:

- a) parimet për përcaktimin e veprimtarive, të veprimeve dhe tipave të të mirave publike, ushtrimi, kryerja dhe përdorimi i të cilave u nënshtrohet licencimit, autorizimit apo lejimit;
- b) parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave, autorizimeve e lejeve dhe parimet për shkaqet e procedurat e revokimit të tyre;
- c) organizimin dhe përmbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve;
- ç) procedurat për trajtimin e disa licencave, të autorizimeve dhe lejeve, në kompetencë të institucioneve qendrore;
- d) Shfuqizuar.

2. Ligji është i zbatueshëm për:

- a) të gjitha licencat e autorizimet, për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake;
- b) të gjitha lejet për përdorimin e të mirave publike, për qëllime të veprimtarive të sipërpërmendura, përveç përdorimit të të mirave publike për qëllime vetjake.

III.2.11. Në nenin 3 “Përkufizim i termav” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- dh) “Institucion tjetër” është çdo institucion qendror ose i pavarur, që ka kompetenca të caktuara për verifikimin e përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe çdo subjekt privat, të cilit i është dhënë, sipas ligjit, një kompetencë e tillë.
- gj) “Licencë” është akti administrativ, që i njej titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- h) “Autorizim” është akti administrativ, që i njej titullarit të saj të drejtën të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- i) “Leje” është akti administrativ, që i njej titullarit të saj të drejtën të përdorë një të mirë publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
- j) “Titullar i licencës/autorizimit/lejes” është personi juridik apo personi fizik, që ka marrë një licencë, autorizim apo leje.
- k) “Kushte të licencimit/autorizimit/lejimit” janë ato kushte, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave nga titullari i licencës/autorizimit/lejes është e detyrueshme.
- l) “Kritere të licencimit/autorizimit/lejimit” është ajo pjesë e kushteve, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës/autorizimit/lejes.
- ll) “Detyrime të licencimit/autorizimit/lejimit” është ajo pjesë e kushteve, që kërkohen të përmbushen përgjatë kryerjes së veprimtarisë, të veprimit apo përdorimit të së mirës publike.
- m) “Dokument provues” është akti shkresor i një institucioni publik, privat apo akti i përgatitur nga vetë kërkuesi e që provon përmbushjen e një kushti licencimi/autorizimi/lejeje.
- n) “Dokument tjetër shoqërues” është një dokument i detyrueshëm për t'u paraqitur, për pajisjen me licencë/autorizim/leje e që nuk është dokument provues.
- nj) “Dokumente shoqëruese” janë dokumentet provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese e të marra së bashku.

III.2.12. Në nenin 6 “Parimet për përcaktimin e veprimtarive që u nënshtrohen licencimit dhe autorizimit” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kriterëve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.

III.2.13. Në nenin 8 “Parimet për përcaktimin e kushteve të licencimit/autorizimit” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Kushtet e licencimit apo autorizimit bazohen në parimet e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative.

2. Kushtet e licencimit apo autorizimit duhet t'u përgjigjen, në mënyrë të përshtatshme, interesave publike që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

3. Kushtet e licencimit apo autorizimit përcaktohen e shprehen, bazuar në tregues objektivë, të matshëm, të thjeshtë e të kuptueshëm.

4. Çdo kërkues, që plotëson kriteret e licencimit apo autorizimit, fiton të drejtën që ta ushtrojë atë veprimtari apo, përkatësisht, ta kryejë atë veprim.

5. Përjashtimisht, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, sipas nenit 6 të këtij ligji, mund të përcaktohet një kufizim sasior i veprimtarive apo veprimeve, nëpërmjet kufizimit të numrit të licencave për atë veprimtari, apo autorizimeve për atë veprim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, nisma ligjore përcakton që licenca apo autorizimi i jepet një numri të kufizuar kërkuesish që, përveçse plotësojnë kriteret bazë të licencimit apo, përkatësisht, autorizimit, arrijnë, gjithashtu, vlerësimin më të mirë, krahasuar me kërkuesit e tjerë, në përputhje me disa kriteret dhe procedura konkurruese, të paravendosura, transparente e të drejta.

III.2.14. Në nenin 12 “Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për revokimin e licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

2. Konstatimi i mosplotësimi të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit ex poste.

3. Përpara marrjes së vendimit të revokimit, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të

arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrin për ripërbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

4. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

5. Licenca/autorizimi/leja, si rregull, revokohen:

a) kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

b) në rast të moszbatimit të urdhërimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.

III.2.15. Në nenin 14 “Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo licencë/autorizim/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

2. Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

3. Regjistri organizohet në tri pjesë:

a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve;

b) regjistri informativ, sipas kategorive të licencave, autorizimeve dhe lejeve;

c) regjistri aplikativ i licencave dhe lejeve.

4. Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore përmban të gjitha projektaktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKB-së.

5. Regjistri informativ përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

a) kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;

b) kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;

c) procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;

ç) udhëzimet për bërjen e kërkesave.

6. Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

a) çdo kërkesë për pajisjen me licencë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;

b) çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;

c) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;

- ç) çdo vendim për urdhërimin e ripërbushjes së kritereve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/autorizimit/lejes apo pezullimin e licencës/autorizimit/lejes;
- d) çdo vendim për revokimin e një licence/autorizimi/lejeje;
- dh) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të kësaj pike;
- e) çdo licencë/autorizim/leje të dhënë e të vlefshme;
- ë) vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/autorizimi/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;
- f) çdo vendim tjetër për një licencë/autorizim/leje të caktuar.

7. Shfuqizohet

8. Regjistri Kombëtar mbahet nga QKB-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKB-ja, çdo institucion i pavarur dhe çdo institucion qendror, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrit Kombëtar për pjesën e licencave/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre.

9. Organi nismëtar i nismës ligjore, me përjashtim kur është institucioni i përmendur në pikën 8 të këtij neni, dërgon projekt-aktin dhe raportin e vlerësimit të pasojave për publikim nga QKB-ja.

10. Çdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kritereve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin Kombëtar, për të publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës për licencim/autorizim/leje.

11. Çdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistër, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

12. Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave “dh” dhe “ë” të pikës 6 të këtij neni, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administron regjistrin për licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete të përshtatshme.

13. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Ministri miraton rregullat e hollësishme për funksionimin e regjistrit, krijimin, administrimin, formatimin, përmbajtjen, lidhjen në rrjet me institucionet e përfshira në procesin e licencimit/autorizimit/lejimit, si dhe procedurat e sigurisë së tij.

III.2.16. Në nenin 20 “Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- 1. QKB-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
- 2. QKB-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kritereve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate,

sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.

3. Nëse QKB-ja konstaton njërën nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.

4. Në rast të kundërt, QKB-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, me mjete elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.

5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKB-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i aftit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKB-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKB-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundërt QKB-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

III.2.17. Në nenin 34 “Njoftimi i vendimeve nga QKB-ja dhe dorëzimi i titullit” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Vendimet e QKB-së, sipas këtij ligji, njoftohen nëpërmjet publikimit në regjistër.

2. Data e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, është data e publikimit në regjistër.

3. Titulli përkatës i dorëzohet kërkuesit në sportel.

III.2.18. Në nenin 35 “Afati i publikimi në regjistër” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Çdo kërkesë dhe çdo vendim i QKB-së apo i një institucioni tjetër, që lidhet me licencimin/autorizimin/lejimin, sipas këtij kreu, publikohet në regjistër brenda ditës së nesërme të punës nga paraqitja e kërkesës apo marrja e vendimit ose e bërjes me dije.

III.2.19. Në nenin 1 “Qëllimi” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

III.2.20. Në nenin 24 “Inspektimi” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Inspektorati Shtetëror Kompetent kryen inspektime në instalimet e tipit A dhe B, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit nr. 10 433, datë. 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Agjencia Rajonale e Mjedisit kryen inspektime në instalimet e tipit C, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

3. Operatori i instalimit, mbi të cilin zbatohet ky ligj, i jep Inspektoratit Shtetëror Kompetent gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në atë instalim, për marrjen e mostrave dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave të veta, për qëllime të këtij ligji dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

III.2.21. Në nenin 27 “Revokimi i lejes së mjedisit të tipit A, B dhe C” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Ministri për lejet e mjedisit të tipit A dhe B dhe ARM-ja përkatëse, për lejet e mjedisit të tipit C mund të pezullojë ose të revokojë lejen e mjedisit kur:

a) paraqitet kërkesë nga vetë mbajtësi i lejes;

b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit;

c) mbajtësi i lejes është dënuar, sipas legjislacionit në fuqi, për një vepër penale në fushën e mjedisit apo ka kryer kundërvajtje administrative po në fushën e mjedisit;


ç) mbajtësi i lejes së mjedisit ka shkelur, në mënyrë të përsëritur, dispozitat e këtij ligji, gjë që ka çuar në vënien e gjobave administrative, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;

d) mbajtësi i lejes nuk ka paguar gjobat administrative, të vëna në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor.

III.2.22. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor,

janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.23. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: “2.1.1 dhe 2.1.2 Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 ”Per lejet e mjedisit” dhe në Termat e Referencës se DST (PËRVEC INCENERIMIT), ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponoje: 1.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe 1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte: 18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03); 18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet; 18 01 04 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.). 2. Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje: 2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe 2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte: 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)” Për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kreu verifikimin në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/>, në lidhje me statusin e lejes mjedisore për të cilën operatori ekonomik ankimues është skualifikuar, nga verifikimi rezultoi si më poshtë:

Leje Mjedisore e tipit A	V.A.L.E.	L28029301Q	PN-8024-01-	Pezulluar	31.01.2019	
	RECYCLING		2019			

Me qëllim shqyrtimin e drejtë dhe objektiv të çështjes me shkresën me nr. 967/11 prot., datë 15.05.2024, iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (në vijim AKM) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) me kërkesën për informacion. Ndër të tjera ka kërkuar si më poshtë:

- 1.Cila është arsyeja që operatori ekonomik V.A.L.E. Recycling” SHPK ka marrë masë administrative lidhur me lejen mjedisore PN-8024-01-2019 dhe cila është masa e gjobës?
- 2.A ka një Vendim Gjyqësor që kjo masë administrative (akt) është pezulluar?

3. Leje mjedisore e leshuar nga ana juaj me këto të dhëna: PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 dhe me Kod III.1.C (), me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për:Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, është e vlefshme apo e pezulluar nga ana juaj? Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 5418/1 prot., datë 20.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 967/13 prot.,datë 22.05.2024, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik se: “Në përgjigje të shkresës suaj nr.967/11 Prot., datë 15.05.2024, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me nr. 5418 prot., datë 17.05.2024, me lëndë ‘Kërkesë për informacion’ ju bëjmë me dije se: Masa administrative e vendosur nga inspektorati vjen si rezultat i mosplotësimit të detyrave të lëna në inspektimin me nr. çeshtje AKM-DQ-2023-000521, date 23.11.2023. Për këtë arsye, subjekti është riinspektuar në datë 25.01.2024 dhe me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.AKM-DQ-2023-000535-5, datë 07.02.2024 për shkak të konstatimit të shkeljeve të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448 datë 7.14.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Neni 29, pika 1, germa c dhe Neni 16, pika 3, është vendosur: • Dënim administrativ kryesor Gjobë: 1 000 000 Lekë;; • Dënimi administrativ plotësues: Referuar inspektimit të kryer në datën 23.11.2023 me nr çështje AKM-DQ-2023-000521 pasi u konstatua se instalimi i inceneratorëve në terren nuk ishte sipas kushtit nr 1 të lejes mjedisore tipi A që disponon me PN-8024-01-2019. Subjektit ju la detyrë si më poshtë: “Subjektit i lihet detyrë të marrë masat e menjëhershme për përcaktimin e saktë të instalimeve në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit sipas lejes mjedisore që disponon me qëllim përshtatjen e lejes mjedisore me instalimet përkatëse në vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit.” Gjatë riinspektimit në terren rezulton se subjekti nuk ka marrë masat e duhura për realizimin e detyrave të lëna. Për subjektin V.A.L.E Recycling me leje mjedisore tipi A, PN-8024-01-2019, propozojmë: Pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit. Pas ushtrimit të ankimit administrativ nga subjekti, vendimi i inspektimit është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me Vendimin nr. 3025 prot., datë 13.3.2024. Me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr. 141 datë 04.04.2024, nr.199715 prot., date 04.04.2024 “Për pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “V.A.L.E. RECYCLING” shpk me PN-8024-01-2019, me veprimtari “Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” me vendndodhje: fshati Gurëz, afër ish-kanalit të acidit, Gurëz, Fushë Kuqe, Laç, Lezhë” deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit. Me Vendimin nr. Regj. Them 7505 datë 29.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur refuzimi i kërkesës së palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në çështjen e ngritur nga pala paditëse Shoqëria V.A.L.E. Recycling shpk me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr.3025 prot., date 13.3.2024 të nxjerrë nga AKM Tiranë” kundër AKM Tiranë si palë e paditur. Çështja është në proces gjyqësor për çështjen e themelit (Shfuqizimin e aktit administrativ nr.3025 prot., datë 13.3.2024).

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është vënë në dijeni nga QKB-ja nëpërmjet shkresës me nr. 3275/33 prot., datë 25.04.2024, regjistruar në AKM me NR. 4890 prot., datë 30.04.2024 për vendimin 80-2024-1075) datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë:

Kërkues: Shoqëria V.A.L.E Recycling shpk

Palë e tretë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Objekti: Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ nr. 1997/5 prot., datë 04.04.2024 Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e cila ka vendosur:

-pranimin e kërkesës për marrje mase sigurimi padie

-pezullimin e zbatimit të aktit adminsitrativ urdhër nr. 141, datë 04.04.2024 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes administrative.

Leja mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019 me datë 22.04.2022 me nr. identifikimi të lejes 2929/2 Vendim i Komisionit Nr.45 në emër të subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” është leje mjedisore e vlefshme.

Me Urdhrin nr.141 datë 04.04.2024, me nr.1997/5 prot., datë 04.04.2024, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është urdhëruar pezullimi i kësaj leje mjedisore deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.

Me Vendimin nr.80-2024-1075 datë 17.04.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është pezulluar zbatimi i këtij urdhri deri në zgjidhje përfundimtare të çështjes administrative.

Gjithashtu bëjme me dije se, referuar kërkesave të bëra nga subjekti për plotësimin e detyrave të lëna nga grupi i inspektimit, në kuadër të ligjit nr. Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer verifikimin në terren në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit të Subjektit “V.A.L.E. RECYCLING” shpk, për lejen e mjedisit të tipit A me PN-8024-01-2019 dhe bazuar në Procesverbalin e inspektimit me Nr.AKM-DQ-2024-000122-2 datë 25.04.2024 dhe listë verifikimin Nr.AKM-DQ-2024-000122-211 datë 25.04.2024, nga grupi i inspektimit nuk janë konstatuar shkelje ligjore duke përmbushur detyrat e lëna. Me shkresën nr.166 prot., datë 12.04.2024, regjistruar në AKM me nr. 4139 prot., datë 12.4.2024, subjekti “V.A.L.E. Recycling” shpk, konfirmon pagesën vullnetare të gjobës prej 1 000 000 lekë, sipas vërtetimit të pagesës nga Banka Kombëtare Tregtare.”

Gjithashtu me shkresën nr. 1427/4 prot, datë 27.06.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon: Së pari, a jeni vënë në dijeni në cilësinë e të paditurit, nëse operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” SHPK ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, për të kundërshtuar aktin administrativ urdhër nr. 141 datë 04.04.2024 të Ministrit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit. Së dyti, cili është statusi ligjor i lejes mjedisore PN-8024-01-2019, me datë lëshimi 22/04/2022 dhe me Kod III.1.C (), me emërtim “Leje Mjedisore e Tipit A për: Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi. Incinerimi i mbetjeve patologjike” për operatorin ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, deri në datë 03.05.2024 (datë kur janë zhvilluar këto procedura prokurimi). Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit me shkresën nr. 4303/1 prot, datë 02.07.2024,

protokolluar me tonën me nr. 1427/6 prot, datë 03.07.2024, informon Komisionin e Prokurimit Publik se “Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 1427/4 prot, datë 27.06.2024, protokolluar pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit menr. 4303 prot, datë 28.06.2024, nëpërmjetë të cilës kërkohet informacion nëse jemi në dijeni në cilësinë e të paditurit që operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK ka paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe cili është statusi ligjor i lejes mjedisore PN-8024-01-2019 më datë lëshimi 22.04.2024 me Kod III.1.C, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Referuar komunikimeve tona zyrtare konkretisht shkresave me nr. 3669/1 datë 10.06.2024 si dhe shkresës nr. 3669/3, datë 20.06.2024 ju bëjmë me dije se më datë 14.05.2024 është depozituar pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit padia dhe aktet bashkëlidhur saj me paditës shoqëria “Vale Recycling” SHPK me objekt: “Shfuqizim akti administrativ”. Më datë 23.05.2024 Ministria e Turizimit dhe Mjedisit në cilësinë e të paditurit ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë prapësimet me shkrim, brënda afateve ligjore. Në lidhje me statusin ligjor të lejes mjedisore, ju bëjmë me dije se për Lejen Mjedisore PN-8024-01-2019 me datë lëshimi 22.04.2024 me Kod III.1.C, me Urdhrin nr. 1997/5 datë 04.04.2024 është vendosur pezullimi i Lejes Mjedisore për subjektin “Vale Recycling” SHPK, me veprimtari “Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme me një instalim incenerimi, incenerimi i mbetjeve patologjike, me vendodhje fshati Gurrës, Fushkuqe, Lac, Lezhë. Bashkëlidhur gjeni Urdhrin nr/1997/5, datë 04.04.2024. Referuar kthim - përgjigjes së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit sikurse më sipër cituam, rezulton, se më datë 04.04.2024 me Urdhrin Nr. 141 Ministri i Turizimit dhe Mjedisit ka vendosur pezullimin e lejes mjedisore për subjektin “Vale Recycling” SHPK me PN-8024-01-2019, me veprimtari “Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. Incenerim i mbetjeve patologjike” me vendodhje fshati Gurëz, afër ish kanalit të acidit, Gurëz, Fush Kuqe, Laç, Lezhë, deri në realizimin e detyrave të lëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për njoftimin e këtij urdhri, Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK. Kjo masë e marrë ka ardhur si rrjedhojë e propozimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit pas inspektimit të bërë ndaj këtij subjekti dhe shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit, vendim i cili edhe pas ankimit administrativ të subjektit me vendimin nr. 33025 prot., datë 13.03.2024, është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, ndaj me propozim të AKM, Ministri i Mjedisit ka nxjerrë Urdhrin nr.141, datë 04.04.2024, me nr. 1997/5 prot, datë 04.04.2024, ku ka vendosur pezullimin e lejes mjedisore më sipër. Referuar situatës faktike dhe juridike të dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër, nga informacioni i dërguar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria Mjedisit dhe Turizimit, si dhe nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/>, rezulton, se në momentin e hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, pra më datë 03.05.2024, Leja e Mjedisit e Tipit A me nr. PN-8024-01-2019 me Kod III.1.C, e subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK, ka qenë dhe vijon të jetë e pezulluar. Ndodhur në këto kushte KPP vëren, se në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me datë 03.05.2024, çka nënkupton edhe datën e hapjes së ofertave për vlerësim, leja e mjedisit e sipërcituar e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK,

ka qenë e pezulluar. Në këtë kuadër KPP gjykon, se operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, në momentin e hapjes së ofertave më datë 03.05.2024, lejen e mjedisit e ka pasur të pezulluar, duke mos arritur të vërtetojë përmbushjen e kriterit 2.1 pika 1.a dhe 2.a kapaciteti profesional i operatorëve të dokumenteve standarde të tenderit, duke rënë ndesh jo vetëm me parashikimet e nenit 77 por edhe të parashikimit të nenit 76 pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Vale Recycling” SHPK, nuk është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga korrespondencat me insitucionet përgjegjëse, si dhe verifikimet e kryera, rezultojnë, se Leja e Mjedisit e Tipit A me nr. PN-8024-01-2019 me Kod III.1.C, e subjektit “V.A.L.E Recycling” SHPK, e lëshuar nga QKB, është e pezulluar në momentin e vendimmarrjes, verifikuar kjo në Regjistrin e Lejeve dhe Licencave të lëshuar nga QKB, në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Pavarisht faktit se për këtë vendim pezullimi, nga ana e operatorit ekonomik ankimes është marrë një vendim mase sigurim padie, vendim i cili nuk është i pasqyruar në Regjistrin aplikativ të Qendrës Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 6 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: *Regjistri aplikativ përmban këto të dhëna: a) çdo kërkesë për pajisjen me licencë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të; b) çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit; c) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë; ç) çdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kriteve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/autorizimit/lejes apo pezullimin e licencës/autorizimit/lejes; d) çdo vendim për revokimin e një licence/autorizimi/lejeje; dh) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të kësaj pike; e) çdo licencë/autorizim/leje të dhënë e të vlefshme; ë) vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/autorizimi/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike; f) çdo vendim tjetër për një licencë/autorizim/leje të caktuar., dhe nenit 14 pika 12 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “Vendimet e gjykatës, sipas shkronjave “dh” dhe “ë” të pikës 6 të këtij neni, i njoftohen nga vetë gjykata, brenda 5 ditëve nga dhënia e tyre, institucionit që administron regjistrin për licencën/autorizimin/lejen, sipas kompetencës përkatëse. Njoftimi bëhet me mjete të përshtatshme”. Në këtë mënyrë, nuk mund të shprehim dhe të vlerësojmë nëse një akt administrativ i lëshuar nga një organ tjetër administrativ, si në rastin konkret, urdhri mbi pezullimin e lejes së mjedisit, i cili nuk ka marrëdhënie hierarkike me Komisionin e Prokurimit Publik është ose jo në përputhje me legjislacionin sektorial. Gjithashtu, ligji i prokurimit publik, aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk parashikojnë në asnjë rast kompetencën e KPP-së për t’u shprehur në lidhje me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e licencave/lejeve, për sa kohë, që si nga konstatimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit ashtu dhe nga informacioni i ardhur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Ministria e Turizimit dhe Mjedisit rezultojnë, se leja e mjedisit nr. PN-8024-01-2019 me Kod III.1.C, figuron e pezulluar. Thëksojmë, se marrja përsipër e një konstatimi të tillë bie në kundërshtim jo vetëm me ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për*

Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, por edhe me nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative në të cilin parashikohet se: “*Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*” Sa më sipër, vlerësojmë se për sa kohë që në regjistrin aplikativ të lejeve dhe licensave, leja mjedisore e tipit A nr. PN-8024-01-2019 me Kod III.1.C, figuron e pezulluar në momentin e hapjes së ofertave më datë 03.05.2024, por edhe në momentin e vendimmarrjes, verifikuar kjo në Regjistrin e Lejeve dhe Licencave të lëshuar nga QKB, në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe nga korespondenca me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizimit si organi epror i caktuar me ligj të posaçëm për miratimin e tyre, Komisioni gjykon, se ndodhemi në kushtet e mospërbushjes së kriterëve për kualifikim, të përcaktuara nga autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt - prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sic u arsyetua më sipër, duke qenë se në momentin e hapjes së ofertave me datë 03.05.2024, por edhe në momentin e vendimmarrjes, leja mjedisore e tipit A nr. PN-8024-01-2019 me Kod III.1.C, e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK figuron e pezulluar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për skualifikimin e tij të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit të KPP-së në pikën III.2 e në vijim të këtij vendimi, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “V.A.L.E

Recycling” SHPK mbetet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur kështu interesin e ankimesit “Eco Riciklim” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-93267-01-17-2024, me objekt “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, me fond limit 17,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri